

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7591 E martë 17 Korrik 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion

Ditës

Duke parë kriteret e transparencës së vetëgjitjes, që duhet të kalojnë gjyqtarët, prokurorët dhe hetuesit (ish), më neverit fakti, se pse nuk kanë përfshirë ...
Vijon në faqen 21

Nga AGRON TUFA

Kush do ta bëjë vetëgjitjen e vetëgjitjes?



Opinion

Ditës

Është e qartë se takimi Trump-Putin sapo ka hedhur themelet e një rendi të ri botëror, të udhëhequr tërësisht prej interesave pragmatiste të fuqive të mëdha ...
Vijon në faqen 21

Nga RALF GJONI

Takimi Trump-Putin si Jalta e dytë për shqiptarët



Revista gjermane komenton Samitin e NATO

"Der Spiegel": Shqipëria, i vetmi vend që u lavdërua nga Donald Trump

Presidenti i SHBA: I vetmi person në këtë sallë që më kupton tamam është kryeministri i Shqipërisë

Revista gjermane "Der Spiegel" i ka kushtuar një shkrim Samitit të NATO-s ku morën pjesë të gjithë liderët e vendeve anëtare, mes tyre edhe kryeministri shqiptar Edi Rama. Në artikullin e "Der Spiegel", flitet edhe për Shqipërinë dhe bisedën që Kryeministri Edi Rama, zhvilloi me Presidentin amerikan Donald Trump gjatë samitit ...
Në faqen 2

HETIMET/ EKZEKUTORI I PAMASKUAR VEPROI I VETEM. DYSHIMI, ERDHI NE TIRANE

ÇIFTI I VRARE NE SHKODER, KAMERAT FILMUAN AUTORIN

Familjarët përcjellin Boran Bërcanën dhe Silvana Ndocin, si "shpëtoi" fëmija 2 vjeç. Motra e viktimës: Dua drejtësi. Policia shoqëron 30 persona



(Në foto) Viktimat Boran Bërcanë dhe Silvana Ndocin. Ekspertët e policisë në vendin e ngjarjes



Në faqen 9

KERKESA E FAMILJES

Prokuroria nuk pranon ekspertizë të re për të riun që vdiq në polici

Në faqen 8

APELI I PRESIDENTIT

Meta: Investime për arsimin, të mbajmë të rinjtë në Shqipëri

Në faqen 6

KOMPENSIMI

Pronat në Korçë, ATP-ja merr në shqyrtim 10 mijë dosje të reja

Në faqen 10-11

SAMITI SHBA-RUSI

Trump takon Putinin në Helsinki: Fillim i mirë, dialogu me Rusinë, pozitiv

Në faqen 12

SOT HOMAZHET NE DURRES



Shuhet mjeshtri i humorit, miqtë: Çastet e fundit me Fadil Hasë

Në faqen 18



Ish-lojtari i Dinamos: Rezultati më i mirë në historinë tonë të futbollit

Një kroat në Tiranë: Si e përjetova Finalen

Matko Djarmati: Pas fitores me Anglinë mora 100 mesazhe nga shqiptarët

Nga EGLA XHEMALI

Të kishte shkuar ndërmend që Kroacia do shkonte deri në finale të Botërorit? Unë do të isha i kënaqur edhe po të ishim në tetëshen më të mirë në botë për ekipin kroat, ekipin e një shteti me 4 milionë banorë.



Kisha shpresë sigurisht edhe për finalen, sepse kemi një brez me super lojtarë, që luajnë në klubet më të mira në botë. Cili është sekret i Kroacisë, një shtet kaq i vogël dhe kaq i suksesshëm në sport? Shumë e vështirë kjo. Nuk ekziston ...

Suplement

SITUATA POLITIKE MAZHORANCA

Rama: Emigrantët të investojnë në vendlindje

Krijohet "Akademia e 100 fshatrave", kryeministri nënshkruan memorandum bashkëpunimi me universitetet



si i programit të Rilindjes Urbane, pasi siç theksoi ai, zhvillimi dhe rritja e fluksit të turizmit që shikojmë sot është rezultat i drejtpërdrejtë i programit të Rilindjes Ur-

bane. Rama tha se falë këtij programi "kemi pasur një rritje të konsiderueshme të aktivitetit sipërmarrës dhe tregtar në të gjitha zonat ku kemi ndërhyrë". "Është një shembull kuptimplotë për atë çka do të shikojmë së shpejti edhe falë programit të Rilindjes Urbane. Fokus nuk do të jenë vetëm 100 fshatrat e përzgjedhur, pjesë e programit të Rilindjes Rurale, pasi nevojat për rritjen e cilësisë së jetës në Shqipërinë rurale janë shumë më tepër", vuri në dukje kryeministri. Kreu i ekzekutivit, Rama theksoi se objektivi i programit është kthimi i 100 fshatrave në

destinacione të mirëfillta turistike për t'i dhënë një hov një zhvillim ekonomik e social aty ku deri sot kjo dukej e pamundur. Po ashtu ky program, vijoi kryeministri, synon të nxjerrë në pah edhe potencialet e mëdha të një qasjeje të ndryshme ndaj së nesërme, ku mundësitë për të zhvilluar bujqësinë janë të kufizuara. "Ne besojmë shumë se turizmi dhe agroturizmi do të shërbejë si një mekanizëm tërheqës drejt fshatit falë bukurive natyrore, trashëgimisë kulturore e historive për të treguar.



Asambleja Kombëtare e Partisë Socialiste

Revista e njohur gjermane rrëfen prapaskenat e samitit të NATO-s javën e kaluar në Bruksel

Spiegel: Trump lavdëroi vetëm Shqipërinë

"I vetmi person në këtë sallë që më kupton tamam është kryeministri i Shqipërisë"

Revista gjermane "Der Spiegel" i ka kushtuar një shkrim Samitit të NATO-s ku morën pjesë të gjithë liderët e vendeve anëtare, mes tyre edhe kryeministri shqiptar Edi Rama. Në artikullin e "Der Spiegel", flitet edhe për Shqipërinë dhe bisedën që Kryeministri Edi Rama, zhvilloi me Presidentin amerikan Donald Trump gjatë samitit. Shqipëria - nënvizon Spiegel - ishte i vetmi vend që u përgëzua nga Trump, ndërkohë që vetë Rama, zhvilloi një takim kokë më kokë me kancelaren gjermane, Angela Merkel. "Ishte mesdite dhe ishte koha për vendet më të vogla të NATO-s të merrnin fjalën e tyre. Ata ishin duke biseduar me Merkelin. Gjatë një pushimi, kryeministri shqiptar, Edi Rama shkoi pranë Kancelares gjermane. Vendi i tij ishte i vetmi që u vegua për t'u lavdëruar nga Trump, por ai nuk donte të krijonte përshtypjen se Shqipëria në njëfarë mënyre ishte bërë nxënësja shembullore e Trump", citohet artikulli i revistës gjermane "Der Spiegel". Kryeministri shqiptar Edi Rama në



Kryeministri Edi Rama dhe Presidenti Donald Trump

Samitin e NATO-s u takua me Presidentin Trump, sekretarin e Shtetit, Mike Pompeo, kancelaren Merkel dhe të tjerë kryeministër dhe të tjerë kryeministër. Të gjitha vendet ranë parimshëm dakord për të shtuar shpenzimet për mbrojtjen, por megjithatë debati për këtë çështje vijon.

DETAJET E SAMITIT TË NATO-S

Kryeministri Edi Rama bisedoi javën e kaluar në Bruksel me Presidentin-

amerikan, Donald Trump. Takimi u zhvillua në kuadër të Samitit të NATO-s, ndërsa kryeministri Edi Rama shpërndau "Foton e Ditës", përmes rrjetit social "Facebook". Po ashtu, i pranishëm në këtë takim ishte edhe Sekretari Amerikan i Shtetit, Mike Pompeo. Burimet nga samiti i NATO-s thonë se presidenti i SHBA ka deklaruar në prani të të gjithëve: I vetmi person në këtë sallë që më kupton tamam është kryeministri i Shqipërisë. "Në seancën plenare të

BISEDË

"Gjatë një pushimi, kryeministri shqiptar Edi Rama shkoi pranë kancelares gjermane. Vendi i tij ishte i vetmi që u vegua për t'u lavdëruar nga Trump, por ai nuk donte të krijonte përshtypjen se Shqipëria në njëfarë mënyre ishte bërë nxënësja shembullore e Trump", citohet artikulli i revistës gjermane "Der Spiegel".

Samitit të NATO-s, Presidenti Trump përshëndeti posaçërisht kryeministrin Edi Rama për fjalën e tij në darkën e mbrëmshme të liderëve të Aleancës", shkroi ministria Olta Xhaçka, e cila e publikoi e para këtë takim në rrjetin social "Facebook". Më pas, kryeministri postoi edhe një video, ku shfaqej ai në bisedë me Presidentin Trump dhe sekretarin Mike Pompeo. Këta të fundit ishin duke dëgjuar më vëmendje ato që fliste kryeministri Rama.

Komisioneri Hahn këtë javë në Tiranë, do takojë Ramën e Metën

Komisioneri për Zgjerim në BE nis sot, takimet me zyrtarët e Shqipërisë dhe Shkupit, ku në axhendë të diskutimeve do të jetë procesi i hapjes së negociatave. Johannes Hahn nga samiti i Ballkanit Perëndimor njoftoi se nga data 17 korrik do të nisë një tur ballkanik që nis me Shkupin pastaj me Tiranën. Gjatë vizitës do të sqarojë hapat që duhen ndërmarrë për procesin scrining për Shqipërinë dhe Maqedoninë, e cila do të shërbejë si një sfidë përgatitore për hapjen e negociatave në qershor 2019. Në kryeqytetin shqiptar eurokomisioneri Hahn do të takohet me Presidentin Meta, me kryeministrin Rama si dhe me përfaqësues të tjerë të qeverisë. Në deklaratën e dhënë për mediat nuk ka parashikuar takime me përfaqësues të opozitës, por siç u shpreh gjatë konferencës në Bruksel diskutimi me ta do të zhvillohet vetëm nëse do të ketë hapësirë në orare. Para vizitës së tij Hahn e ka bërë të qartë se Shqipëria do të vijojë zbatimin e reformave dhe me plotësimin e 5 prioritetëve për të marrë përgjigje pozitive në lidhje me negociatat. Në Shkup, Hahn do të zhvillojë takim me kryeministrin Zoran Zaev, me kryetarin e Kuvendit Talat Xhaferi me përfaqësues të partive politike si dhe me aktorë të shoqërisë civile dhe biznesit. Por në këtë takim Hahn nuk parashikon që të takojë Presidentin Ivanov. Një veprim i tillë vjen kur kreu i shtetit ka refuzuar të firmosë marrëveshjen me Greqinë për emrin Maqedonia e Veriut.





Në vjeshtë do të bëhet analiza e punës së ministrave, kriteret e vlerësimit

PS shtyn në vjeshtë Asambleenë Kombëtare, Balla-ministrave: Mos mungoni në seanca

Fushata zgjedhore, deputetët porositën të kontaktojnë bazën

Kryeministri Edi Rama njëherësh edhe në cilësinë e kryetarit të Partisë Socialiste shtyu për në shtator mbledhjen e Asamblesë së partisë, ku do të niste analiza për punën e bërë në një vit qeverisjeje për çdo ministër. E planifikuar për në korrik, mbledhja e Asamblesë Kombëtare u njoftua dje se do të shtyhet për në vjeshtë duke shtuar kështu ankthin e ministrave, të cilët u lajmëruan më herët se do të duhet të kalojnë në testin e kryeministrit. Mësohet se shkak është bërë vijimi i analizës së punës dhe turrit të llogaridhënies. Gjatë mbledhjes së asamblesë pritet të bëhet analiza e punës së qeverisë e bilanci i bashkëqeverisjes me qytetarët. Ministrat kanë ende shumë takime të pambyllura në zonat e tyre të delegimit, në kuadër të llogaridhënies publike.

Ndaj u është lënë kohë që këto t'i mbyllin në ditët e fundit të korrikut. Ndërkohë që pas pushimeve të verës do të ketë një analizë më të plotë. Burimet nga mbledhja e grupit parlamentar e zhvilluar dje, nën drejtimin e kreut të grupit Taulant Balla bënë me dije se ministrat kanë marrë një tjetër vërejtje, për mungesat e tyre të shpeshta gjatë seancave parlamentare. Balla u ka kërkuar të koordinojnë vizitat jashtë vendit në mënyrë që në seancat që kanë mbetur të mos ketë mungesa, për shkak edhe të numrit të votave që kërkohen për një sërë projektligjesh. Më herët edhe kryeministri Rama ka kërkuar që deputetët e ministra të jenë të pranishëm në seancë. Një tjetër vërejtje e Ballës për ministrat e kabinetit ishte ajo që kishte të bënte me reagimin e tyre dhe përballjen me akuzat e opozitës, në mënyrë që ato të sqarohen deri në fund dhe me kundërfakte. Balla ka kërkuar reagim më të qartë dhe të detajuar për akuzat që ngrihen, në mënyrë që ato të sqarohen deri në fund dhe me kundërfakte.

ANALIZA

Burimet nga PS bënë me dije se analiza e punës së çdo ministri do të jetë e detajuar. Kështu një nga kriteret do



KRITERI

Burimet nga PS bënë me dije se analiza e punës së çdo ministri do të jetë e detajuar. Kështu një nga kriteret do të jetë ajo e numrit të marrëveshjeve që secili ministër ka nënshkruar dhe dobiet që sjell secila nga marrëveshjet e nënshkruara.

REAGIMI

Një tjetër vërejtje e Ballës për ministrat e kabinetit ishte ajo që kishte të bënte me reagimin e tyre dhe përballjen me akuzat e opozitës. Balla ka kërkuar reagim më të qartë dhe të detajuar për akuzat që ngrihen, në mënyrë që ato të sqarohen deri në fund dhe me kundërfakte.

Shqipëria prezanton për herë të parë objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm

Zv. kryeministria Mesi, në aktivitetin e OKB, takime të nivelit të lartë në SHBA

Zëvendëskryeministria e Republikës së Shqipërisë, Senida Mesi do të jetë e pranishme në New York të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA) ku do të marrë pjesë në Forumin e Lartë Politik të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) në prezantimin e Raportit Vullnetar Kombëtar për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDGs), raport i cili konsiston në rrugëtimin e



vendit tonë në drejtim të arritjes së këtyre objektive universale të OKB, e njohur ndryshe si "Axeenda 2030" ose "Objektivat Globale", një thirrje universale e përqafuar nga Shqipëria

para 3 vitesh, e cila ka për qëllim kryesor ndërmarrjen e veprimeve konkrete nga çdo shtet në çrrënjosjen e varfërisë, mbrojtjen e planetit dhe garantimin që çdo popull të gëzojë paqe dhe prosperitet. Axxhenda e zëvendëskryeministres Mesi në New York do të jetë e ngarkuar me disa takime zyrtare me përfaqësues të lartë të OKB-së si: zv.Sekretarja e Përgjithshme e OKB Amina Mohammed; nënkryetarja e Përgjithshme për Çështjet Politike në OKB Rosemary Di Carlo; administratori i UNDP Achim Steiner etj. Gjatë qëndrimit në SHBA, Mesi do të zhvillojë, gjithashtu, takim dhe aktivitet me përfaqësues të diasporës shqiptare.

Bylykbashi kritika KPK-së: U vu gozhda e fundit mbi arkivolin e Kushtetueses

Deputeti demokrat, Oerd Bylykbashi reagoi dje, pas pezullimit nga KPK të gjyqtarit Gani Dizdari. "Sot gjyqtari i fundit kushtetues u shkarkua nga komisioni i nëpunësve administrativë të vetingut. Përfundimisht prej sot, nga 9 anëtarët e dikurshëm, kemi vetëm një kryetar me mandat dhe një anëtar me mandat të përfunduar që pret zëvendësimin prej kohësh. Pra, praktikisht kemi vetëm një anëtar. Sot u vu gozhda e fundit mbi arkivolin e Gjykatës Kushtetuese", u shpreh Bylykbashi. "Edhe Gjyqtarit Kushtetues Dizdari?, nëpunësit e komisionit të vetingut i paskan gjetur një shkelje të "tmerrshme" njësoj si Gjyqtarit të Lartë Tomë Ndreca. Është shoqëruar me nipin e tij që qenka dënuar për ushtrim të paligjshëm të ndikimit mbi një zyrtar shtetëror. Madje paska udhëtuar me makinën e tij. Tmerr: vërtet krim të rëndë paska bërë. Ka ndenjur me nipin!! Si mund ta bënte këtë ai?!", ironizoi Bylykbashi. E duke vijuar ironinë, Bylykbashi tha se "së shpejti do të montojnë altoparlante tek ndërtesa e vetingut, të të dëgojë e brohorasë "populli" (i organizuar me projekte OJF-sh si ato të tendave të vetingut), siç brohoriste në 1945 kur dënoshin armiqet e popullit nga gjyqet partizane me gjyqtare që kishin zbritur nga mali".

Kreu i FRPD, Këllici paralajmëron Ramën: Protestat do vazhdojnë edhe gjatë verës

Prej kohësh tashmë të rinj nga forumet rinore të PD dhe LSI kanë nisur protesta kundër qeverisë dhe Kryeministrit Edi Rama, në të gjitha turet e tij të llogaridhënies. Dhe duket se këto protesta do të vazhdojnë edhe gjatë verës. Deklarata është bërë nga kreu i FRPD-së Belind Këllici, i ftuar në emisionin "Intervista e Ditës" me Erjon Çikun. Në fjalën e tij Këllici tha se janë të vendosur tashmë që të protestojnë kundër qeverisë dhe Kryeministrit Rama, duke e ndjekur këtë të fundit "këmba-këmbës". Sipas Këllicit, ka shumë të rinj pa asnjë angazhim politik, që janë të pakënaqur me qeverisjen e vendit, të cilët i bashkohen protestave të FRPD-së. Por nga ana tjetër, në këto protesta nuk kanë munguar as përplasjet me policinë, që, siç nënvizon Këllici, kanë ardhur me urdhëra nga lart, edhe pse të rinjtë kishin leje paraprake për zhvillimin e tubimeve. Vetë Këllici thotë se përmes forcës, kërkohet që t'u mbyllet goja të rinjve, madje edhe përmes shantazheve dhe procedimeve penale. Megjithatë, kreu i FRPD-së thekson vendosmërinë e të rinjve demokratë për të vijuar me protestat e tyre ndaj kryeministrit Rama.

të jetë ajo e numrit të marrëveshjeve që secili ministër ka nënshkruar dhe dobiet që sjell secila nga marrëveshjet e nënshkruara. Një tjetër kriter do të jetë edhe largimi nga puna e atyre që Rama i ka cilësuar "grabitqarë" në

administratë. Por, gjithsesi kryeministri qysh tani e ka të qartë punën e çdo anëtarit të kabinetit të tij, ndaj edhe nuk e ka të vështirë të verë gishtin mbi atë që do të duhet të lëshojë pozicionin e tij. Por, burimet thonë se

nuk është çudi fakti që Rama të lërë në fuqi të njëjtin kabinet që ka krijuar një vit më parë. Gjithsesi kjo do të mbetet për t'u zbuluar në vjeshtë, kur edhe analiza brenda PS-së të ketë përfunduar krejtësisht.

PROJEKTI DEBATI

Opozita kërkon informacion për truallin e bashkisë ku do të ndërtohet teatri, Bare: Po bëni luftë

"Teatri", Vokshi: Sa tokë ka "Fusha"? Pjetri: Koha, e pamjaftueshme Boçi: S'je shtatanik, se je 1.90 i gjatë

Valentina Madani

Cështja e truallit të Teatrit Kombëtar shkaktoi sërish dhe debat politik në Komisionin parlamentar të Medias, ku ishte thirrur në një seancë dëgjimore kreu i hipotekës, Valdrin Pjetri. Opozita i kërkoj informacion nga kryerregjistruesi për sipërfaqen aktuale të pronës ku ndodhet Teatri Kombëtar, ndryshimet që ka pësuar ndër vite, mënyrën e tjetërsimit të pronave rreth saj dhe pronarët kufitarë me godinën e teatrit. "Ju kemi kërkuar: E para, hartën e zonës që ju nuk na e keni vënë në dispozicion, megjithëse ka qenë e cëluar edhe me 'bold'. Hartën ju nuk e keni sjellë, hartën e pronës. Sa metra katrorë ka 'Fusha' sh.p.k. dhe sa kanë pronarët e sa bashkia?", pyeti kryetarja e komisionit nga radhët e PD, Albana Vokshi. Por të dhënat për tokën private sipas kryerregjistruesit nuk mund t'i vihehin në dispozicion Kuvendit, pasi ishte shkelje e Kushtetutës. "Zyra mund të japë informacion vetëm për truallin me pronar shtetin. Për të tjerat, askush s'mund të nxjerrë informacion", theksoi z.Pjetri. Ndërsa Albana Vokshi u përgjigj: "Ju refuzoni që t'i jepni Kuvendit, në shkelje kushtetuese dhe në shkelje të ligjit, jam e sigurt me urdhr nga lart ju po refuzoni përsëri të jepni informacionin që ju kemi kërkuar. Cila dispozitë ligjore ju ndalon ju të sillni këtu një informacion"? Për Valdrin Pjetrin: "Nuk e lejon Kushtetuta dhe as ligji për të dhëna personale. Mbrohen nga ligji për të dhëna personale. Nëse ata japin pëlqimin, informacioni jepet". Kryerregjistruesi Valdrin Pjetri sqaroi se në total në këtë zonë janë mbi 2 mijë metra katrorë truall shtetëror, ndërsa nuk ka detajuar të tjera të dhëna, duke i konsideruar sekret. "Sa i takon pronësisë shtet janë rreth 2100 metra nga një mbledhje që bëme tani dhe janë mbledhur shifrat që ju keni në tryezën tuaj", tha z.Pjetri. Po për kryetaren e komisionit, Albana Vokshi, kjo përgjigje është e pasaktë dhe për këtë duhen detaje. Ky argument i kryerregjistrues-



Komisioni Parlamentar i Medias

REPLIKAT E PLOTA NË KOMISIONIN PARLAMENTAR TË MEDIAS

ALBANA VOKSHI: Fike mikrofonin, ta jap unë fjalën.

BESNIK BARE: E drejtoni këtë komision sikur po bëni luftë.

ALBANA VOKSHI: Nuk e zgjidhni dot ju opozitën.

Valdrin Pjetri: Në datën 9 dhe 10 mora ftesën në komision për t'u paraqitur. Kohë e pamjaftueshme për të sjellë informacion. Albana Vokshi: Cila prej pikave nuk duhet që ju t'i u përgjigjesht. Na duhet informacion sa tokë ka "Fusha".

Valdrin Pjetri: Në kërkesën tuaj s'e keni përmendur "Fushën". Luciano Boçi: S'je shtatanik, se je 1.90 i gjatë. Ne kemi kërkuar cila është prona e privatit, ti mund të thoshe pa emër "Prona private ka kaq". Ti zhytesh në thellësi për t'u fshehur këtu. Baza e këtij diskutimi është 'ligji Fusha'. Vetë "Fusha" e ka dhënë pëlqimin e tij. Vetë kryeministri ka thënë në parlament që "Fusha" do zhvillojë këtë truall pasi ka tokë.

Albana Vokshi: Çfarë të negociojmë, tokën?

Luciano Boçi: Thirrja jote këtu para komisionit ka kontekst shumë të thjeshtë. "Fusha Company" sa sipërfaqe ka? Sa është pjesa e shtetit? Sa është sipërfaqja që ka "Fusha"? Ky është thelbi i debatit parlamentar.

Albana Vokshi: Beja jeni shumë nervozë. Sa herë ka diskutim koncesionesh ndërhyr. I ke dhënë 400 e ca mln asaj për koncesionet.

Ilir Beja: Jo, jo, i kam dhënë 100 mln javë për javë. Tani, kjo është kërkesa. Kjo është kartela që ka shteti shqiptar, tani kërkon hartën. Bëni një kërkesë të dytë.

it Pjetri mjaftoi që kryetarja e Komisionit të medias ta deklarojë të mbyllur mbledhjen. "Ju refuzoni, e deklaroj mbledhjen e mbyllur: Qeveria nuk do të bëjë transparencë...", deklaroi zj.Vokshi. "Nuk do të sjellë asgjë, është urdhëruar mos sjellë asgjë, ju këtë e kuptoni. Unë e di shumë mirë se çfarë kërkoj dhe ne e dimë shumë mirë se çfarë kërkojmë. Ju nuk e dini se ku po e çoni veten", u shpreh deputetja e PD-së. Gjatë debatave në komision, Vokshi ka replikuar edhe me socialistin Besnik Bare dhe ish-ministrin Ilir Beja, të cilin e akuzoi sërish për koncesionet në fushën e Shëndetësisë. Pas

debateve të shumta, opozita është detyruar të lërë komisionin duke i kërkuar kryerregjistruesit që të sjellë në komision të gjitha të dhënat e kërkuara. Pas ikjes së opozitës, maxhoranca e vijoi e vetme mbledhjen, ndonëse pa kuorumin e mjaftueshëm të deputeteve.

ALBANA VOKSHI

"Edi Rama dhe Erion Veliaj kanë justifikuar miratimin e 'ligjit Fusha' me pretendimin se ai ishte pronar kufitar me Teatrin Kombëtar. Deri më tani, me gjithë kërkesat tona të shumta, ata kanë refuzuar të bëjnë transparencë mbi pronën konkrete të kompanisë "Fusha", tha Vokshi.



Gjatë një seance parlamentare

VALDRIN PJETRI

"Zyra mund të japë informacion vetëm për truallin me pronar shtetin. Për të tjerat, askush s'mund të nxjerrë informacion. Nuk e lejon Kushtetuta dhe as ligji për të dhëna personale. Mbrohen nga ligji për të dhëna personale. Nëse ata japin pëlqimin, informacioni jepet".

Denoncimi te Berisha: Narkoshteti, terror ndaj bizneseve në Himarë, Ksamil dhe Delvinë

Ish-kryeministri Sali Berisha akuzoi dje se qeveria po ushtron presion ndaj bizneseve në Himarë, Sarandë, Ksamil dhe Delvinë. Në adresë të Berishës, qytetari dixhital shkruan se Hetimi Tatimor dhe Krimi Ekonomik po masakrojnë bizneset me gjoba dhe sekuestrim malli. Mes të tjerash, qytetari shkruan se militantët e PS po kërcënojnë me gjoba në Delvinë. Ndërkohë, një tjetër qytetar shkruan se e njëjta situatë po ndodh edhe në Ksamil. "Terror i narkoshtetit ndaj bizneseve ne Himarë, Sarandë, Ksamil, Delvinë! Sb. Përsëritet doktor: Hetimi Tatimor, Krimi Ekonomik bëjnë masakër në Delvinë, gjoba, sekuestrim malli marrje rryshfeti aty ku ka lekë dhe presione nga më të poshtër këta maskarënj me kollare janë mili-



Ish-kryeministri Sali Berisha

tantët të PS. Njëri prej tyre është Niku Kohila, kushëri i parë i Gjergji Kohiles. Këta grinë dynjanë në gjoba dhe në Ksamil Sarandë deri në Himarë dhe marrin edhe rryshfet nëpërmjet kërcënimeve mafioze. Fitore-fitore, rroftë PD". "Prsh. doktor, kjo është

Noriega e Ramës që ka zbarkuar në Ksamil dhe futen në çdo shpi, dhomë, kasolle, kontrollojnë çdo sirtar të njerëzve i kanë grirë me gjoba. Nuk pyesin fare je në rregull apo jo, vetëm mbushin bllokun", thuhet në mesazhin drejtuar z.Berisha.



SHPLLJE ANKANDI

Zyra Perbarimore "E.G. Bailiff Service" me përbanues Enuar Merko me adresë Rr Ibrahim Rozova, Pall.64, Hyrja 8, Ap. 1, Tirane, njofton se me datë 10.08.2018 ora 9⁰⁰ -16⁰⁰ në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankand i lli për shitjen e pasurisë të paluajtshme Truall me sipërfaqe 24.405.50 m² e ndodhur në rruçën "Ali Shëfqeli", Tiranë me Nr.pasurie.9/609, Volumi.20, Faqe.6, në pronësi të Shoqërisë BAU-CONSTRUCTION sh.p.k me vlerë fillestare në ankand 341.676.72 (Tregind e dyzet e një mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e gjashtë pikë shtatëdhjetë e dy) EURO.

Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, 355 4 22 31 888. email enuar_merko@gmail.com



Shitje me Ankand te Pare nga Studio Perbarimore L.D.C

-Apartamenti me nr. 2/260+2-6, vol 30, faqe 140, sip. 104.12 m2, ZK 8330, regjistruar ne Z.V.R.P.P. Tirane. Çmimi fillestar për shitje është 6.413.792 Leke.

Data e shpalljes 27.06.2018

Data e zhvillimit 20.07.2018 deri ne oren 16.⁰⁰

Ankandi zhvillohet ne ambientet e Studios Perbarimore L.D.C me adrese Rruga "Myslym Shyri" Vila 8/1, kati 1 Tirane.



Valentina Madani

Kryetari i grupit parlamentar të LSI, Petrit Vasili, i dërgoi dje një letër kryetarit të Kuvendit, Gramoz Ruçi duke i rikujtuar nismën e kësaj force politike për koncesionet. Sipas Vasilit, nisma e LSI për koncesionet, e cila është depozituar në Kuvend në 2016-ën është bllokuar qëllimisht dhe arbitrarisht nga Komisioni i Veprimtarisë Prodhuese në Kuvend, prandaj kërkon ndërhyrjen e Ruçit. Vasili shprehet se Komisionet Parlamentare përgjegjëse nuk e kanë marrë në shqyrtimin nismën e LSI për koncesionet, një projektligji i dorëzuar në Kuvend në vitin 2016, por që ende nuk është hedhur në votim. Kryetari i Komisionit parlamentar të Ekonomisë dhe Financave, Erion Braçe paralajmëroi ndërhyshimin e ligjit për koncesionet në muajin shtator.

KERKESA

"Unë e kuptoj ndjeshmërinë dhe njëanshmërinë tuaj për mazhorancën që ju ka zgjedhur, por ju kujtoj se administrimi i jetës parlamentare në respekt të Rregullores së Kuvendit dhe monitorimi i saj janë detyrë e juaja", tha z.Vasili.

Nisma në Kuvend që në 2016, LSI: Komisionet përgjegjëse, nuk e kanë marrë në shqyrtim

Koncesionet, Vasili letër Ruçi: Ndërhyni, bllokimi i qëllimshëm

"Çdo koncesion të mos kalojë nga qeveria, por nga Kuvendi"

Por pas deklaratave të tij, reagoi kryetari i grupit të LSI, Petrit Vasili, teksa kujton se LSI ka depozituar një nismë ligjore në Kuvend në 2016-ën, ku kërkon që çdo koncesion mbi 4 vjet të kalojë në parlament, ndërsa duhet të japë miratimin Ministria e Financave, e Ekonomisë dhe Avokatura e Shtetit. Lëvizja Socialiste për Integrim kërkon në nismën ligjore që koncesionet të mos kalojë nga qeveria, por nga Kuvendi. Vasili shprehet se komisionet parlamentare përgjegjëse nuk e kanë marrë në shqyrtimin nismën e LSI për koncesionet, prandaj kërkon ndërhyrjen e Ruçit. Numri dy i LSI shprehet se shqyrtimi i projektligjit të Lëvizjes So-



Kryetari i grupit parlamentar të LSI, Petrit Vasili

Ekonomisë dhe Financave, Erion Braçe deklaroi sot se në ligjin e ri për koncesionet duhet të parashikohet heqjen e 'ofertave të pakërkua'. Vasili shkruan më tej: "Unë e kuptoj ndjeshmërinë dhe njëanshmërinë tuaj për mazhorancën, që ju ka zgjedhur, por ju kujtoj se administrimi i jetës parlamentare në respekt të Rregullores së Kuvendit dhe monitorimi i saj janë detyrë e juaja. Tolerimi i një situatë të tillë, kur nisma e Grupit Parlamentar të Lëvizjes Socialiste për Integrim bllokohet në mënyrë arbitrare dhe të paligjshme është një përgjegjësi e drejtpërdrejtë e juaja. Për sa më sipër kërkoj nga ju të evidentoni përgjegjësit dhe përgjegjësit e kësaj situatë tepër të rëndë e të paprecedent në jetën parlamentare si dhe kthimin e funksionimit të komisioneve parlamentare jo sipas dëshirës dhe interesit politik të ditës së mazhorancës, por në përputhje me rregulloren e Kuvendit".



REPUBLIKA E SHQIPËRISË INSTITUCIONI I KOMISIONERIT PUBLIK

NJOFTIM

Institucioni i Komisionerëve Publikë, bazuar në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjykatrëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe vendimin e Kuvendit nr. 94/2017, "Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Institucionit të Komisionerëve Publikë", rishpall vendet vakante për pozicionet:

Përkthyes (paga II-b)

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijon:

- Të zotërojë diplomë të nivelit Master shkencor në gjuhë të huaja, dega Anglisht ose Drejtësi dhe të ketë minimumi 5 vjet eksperiencë në përkthim shqip-anglisht-shqip.
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
- Kanë përparësi kandidatët me eksperiencë pune pranë organizatave ndërkombëtare.

Preferohen kandidaturat e licencuara përkthyes zyrtar nga Ministria e Drejtësisë.

Specialist Protokolli/Arkiv (IV-b)

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijon:

- Të zotërojë diplomë të nivelit Master shkencor.
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
- Të ketë të paktën 3 vite përvojë pune në profesion.

KUSHTETË PËRGJITHSHME

Kandidatët duhet të sigurohen se plotësojnë kriteret për t'u pajisur me certifikatë sigurie, sipas Vendimit të Këshillit Ministrave nr. 188, datë 4.3.2015.

Kandidatët duhet të kenë aftësi për t'u përshtatur e punuar në grup, nën presion, si dhe në afate kohore të limituara.

Të gjithë aplikimet duhet të dorëzohen në një nga format e dhëna më poshtë:

- Paraqitjes së kërkesës dorazi nga aplikanti nga data 23 deri 27 korrik 2018, së bashku me dokumentet përkatëse, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, në adresën: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" nr. 4, Tiranë, nga e hëna në të premte, ora: 09:00-16:00.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentet përkatëse, me anë të postës pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë në adresën: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" nr. 4, Tiranë. Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda datës 27.7.2018 dhe të vërtetohet me Nfëtimadatin e fësuar nga zyra postare.

Në kërkesën që paraqet, kandidati përcajon vendin vakant, për të cilin është i interesuar. Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon të nbyllura në zarf: 1 kopje të dokumenteve të mëposhtme:

- Jetëshkrimin profesional përshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare.
- Fotokopje e dokumentit të identifikimit (letërnjoftim, pasaportë, kartë identiteti).
- Dokumentet (diplomë, librezë pune, vërtetime, dëshmi, vetëdeklarim, certifikata, trajnime etj.) fotokopje ose të noterizuar. Diplomën që janë marrë jashtë vendit duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njësimin e diplomave, sipas legjislatcionit në fuqi.
- Dokument që vërteton se në ngarkim të tij nuk është regjistruar një procedim penal (vërtetim nga Gjykata, vërtetim nga Prokuroria, dëshmi e gjendjes gjyqësore).
- Vërtetim nga institucioni ku punon që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- Një rekomandim nga punëdhënësi.
- Raport që vërteton se është në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme.

Kandidatët që plotësojnë kriteret formale dhe kanë depozituar dokumente të fotokopjuara, përpara intervistës i parashitrojnë Komitetit ad-hoc dokumentet e njësuara ose ato origjinale.

cialiste për Integrim është zvarritur në mënyrë arbitrare, ndërsa evidenton faktin që janë dy komisione përgjegjëse për ta shqyrtuar dhe votuar, Komisioni i Veprimtarisë Prodhuese dhe Komisioni i Ekonomisë dhe të Financave. "Këto komisione në shkel-

je flagrante të ligjit kanë bllokuar totalisht shqyrtimin e nismës, pavarësisht se ka qenë vazhdimisht e miratuar në programin e Kuvendit dhe kalendarin e punimeve. Kjo është përgjegjësi juaj e drejtpërdrejtë", thotë Vasili. Kryetari i Komisionit parlamentar të

Arkivë 'online' për dosjet e bashkëpunëtorëve të Sigurimit

Deputeti çek: Hapja e dosjeve nuk sjell asnjë pasojë në shoqëri

Dosjet e bashkëpunëtorëve të Sigurimit të Shtetit do të publikohen në një faqe të posaçme. Në një takim të posaçëm ku mori pjesë dhe deputeti çek, Pavel Zacek, u theksua se tashmë disa studiues të rinj kanë nisur punën: "Komunizmi do të kthehet në një platformë për të denoncuar dhe zbuluar krimet e komunizmit. Një ekip kërkuesish të rinj të angazhuar për të zbuluar përgjegjësit e krimeve do të zbulojë emrat e tyre". Për deputetin çek, hapja e dosjeve nuk sjell asnjë pasojë në shoqëri. "Në Çeki kemi nisur hapjen e dosjeve që herët pa asnjë ndalim ligjor. Dosjet e plota të bashkëpunëtorëve dhe punonjësve të sigurisë së diktaturës



janë hedhur të plota në internet. Në faqen e Institutit çek për Studimin e Komunizmit gjen edhe dosjen e ish-presidentit apo të çdokujt tjetër. Hapja e dosjeve nuk ka asnjë pasojë, por ka shërbyer për transparencë të madhe", de-

klaroi z.Pavel Zacek. Për studiuesin Uran Butka, propaganda e ngriti komunizmin në mit. Studiuesit nënvizuan rëndësinë e zbardhjes së vërtetës, si një mundësi për të shikuar përpara dhe për të mësuar prej së shkuarës.

Presidenti i Republikës: Duhet më shumë investime në arsimin profesional

Meta: Një nga problemet tona, të mbajmë të rinjtë në vend

Vizita në Lezhë, për njohjen me kurset

Në kuadër të Ditës Botërore të Aftësive Rinore, Presidenti i Republikës, Ilir Meta vizitoi dhe shkollën profesionale "Rogacionistët" në Lezhë, të drejtuar nga At Antonio Leuci. Meta u njoh nga afër me zhvillimin e kurseve profesionale për përgatitjen e të rinjve e me rezultatet e punës dhe prodhimet e tyre. Kreu i shtetit vuri në dukje se: "Një vizion i pashoqëruar me veprim mbetet një ëndërr! Një nga problemet tona më të mëdha është që t'i mbajmë të rinjtë këtu në vendin tonë. Dhe jo vetëm kaq, por t'i mbajmë duke u dhënë një mundësi. Formimi profesional është mundësia më e mirë që u japim të gjithë të rinjve e të rejave për të filluar jetën me guxim e vetëbesim, me siguri e për ta ndërtuar atë në mënyrë të ndershme e të sigurt". Meta duke iu drejtua kryesisht të rinjve, u shpreh se: "Në vitet e fundit është treguar një vëmendje edhe më e madhe për arsimin profesional, por jemi shumë larg asaj që duhet, sepse arsimi fiktiv i të rinjve ka qenë nga problemet tona kryesore pas viteve '90-të dhe sidomos pa i orientuar drejt një profesioni të caktuar. Ndërkohë që është shumë e vlefshme për t'i edukuar e formuar të rinjtë me kurse, sikurse ishte grupi për impiantin votovoltai apo për shumë teknologji të reja, për të cilat ka nevojë dhe për të cilat tregu i punës ka një mungesë të madhe".

VIZITA

Presidenti i Republikës, Ilir Meta, gjatë kësaj veprimtarie ku ishin të pranishëm drejtues të pushtetit vendor, deputetë të Kuvendit, përfaqësues diplomatikë të Nunciaturës Apostolike dhe Ambasadës së Italisë e Francës, përfaqësues të sipërmarrjes etj., u njoh nga



Presidenti i Republikës, Ilir Meta
dhe në shkollën profesionale
"Rogacionistët" në Lezhë



PRESIDENTI

"Lezha është një nga qendrat kryesore të kulinarisë në Shqipëri, që spikat për shumëllojshmërinë, për klasin, elegancën, për finesën, traditën dhe ky është një opinion që dëgjojmë nga shumë të huaj, të cilët sidomos kanë shumë përvojë në fushën e turizmit, agroturizmit, kulinarisë. Ndaj besoj se ky formim profesional në këtë fushë është një mundësi e shkëlqyer për të gjitha ato të reja e të rinj që gjejnë punë sa më të mira".

afër me zhvillimin e kurseve profesionale për përgatitjen e të rinjve e me rezultatet e punës dhe prodhimet e tyre: punimet dhe qëndisjet me dorë, recetat e

shijshme të grupit të kuzhinës si dhe punën e grupit të fotovoltaikeve. Presidenti i Republikës vuri në dukje se: "Një vizion i pashoqëruar me veprim mbe-

tet një ëndërr! Një nga problemet tona më të mëdha është që t'i mbajmë të rinjtë këtu në vendin tonë. Dhe jo vetëm kaq, por t'i mbajmë duke u dhënë një mundësi.

Formimi profesional është mundësia më e mirë që u japim të gjithë të rinjve e të rejave për të filluar jetën me guxim e vetëbesim, me siguri e për ta ndërtuar atë në mënyrë të ndershme e të sigurt". Duke folur për vlerat tradicionale të lezhjanëve dhe atraksionet turistike të zonës, kreu i shtetit vuri në dukje se: "Lezha është një nga qendrat kryesore të kulinarisë në Shqipëri, që spikat për shumëllojshmërinë, për klasin, elegancën, për finesën, traditën dhe ky është një opinion që

ARSIMI PROFESIONAL

Formimi profesional është mundësia më e mirë që u japim të gjithë të rinjve e të rejave për të filluar jetën me guxim e vetëbesim, me siguri e për ta ndërtuar atë në mënyrë të ndershme e të sigurt. Meta duke iu drejtua kryesisht të rinjve, u shpreh se: "Në vitet e fundit është treguar një vëmendje edhe më e madhe për arsimin profesional, por jemi shumë larg asaj që duhet.

dëgjojmë nga shumë të huaj, të cilët sidomos kanë shumë përvojë në fushën e turizmit, agroturizmit, kulinarisë. Ndaj besoj se ky formim profesional në këtë fushë është një mundësi e shkëlqyer për të gjitha ato të reja e të rinj që gjejnë punë sa më të mira. Njëkohësisht është edhe një mundësi shumë e mirë rritja e cilësisë së shërbimit në fushën e kulinarisë e të ushqimit, për të rritur më tej edhe interesin e turizmit të vendit tonë, pasi dihet se edhe ushqimi, përveç bukurive natyrore, përveç trashëgimisë kulturore e historike, ka një rol shumë të rëndësishëm në promovimin dhe në nxitjen e turizmit". Apeli i Presidentit të Republikës ishte me megjithatë, duhet të bëjmë shumë më tepër për të mbështetur të rinjtë tanë. Duhet të bëjmë shumë më tepër për të investuar në arsimin profesional me baza të forta e konkrete dhe praktike. "Ne duhet t'i u përshatemi zhvillimeve të globalizimit në një mënyrë sa më të shpejtë e sa më krijuese, duke i informuar të rinjtë, sidomos në ato fusha ku krijohet më shumë vlerë e shtuar, ku puna është më e sigurt dhe ku gjithmonë ata do të jenë të domosdoshëm në tregun e punës. Përndryshe u krijojmë një iluzion dhe ua bëjmë më të vështirë të ardhmen", - tha Meta.

Shtim të korsive për biçikletat në Tiranë

Veliaj: S'kemi kohë për të humbur as me teatrin

POLITIKA

"E patëm një alternativë që s'prekte gjë me dorë dhe flinte gjumë. E kishim katër vjet dhe e dimë si përfundoi. Jam shumë i bindur se Tirana do të vazhdojë ritmin e modernizimit. Siç kishim debat për Parkun e Liqenit, ja ku është sot; siç kishim debat për Pazarin e Ri, ja ku është sot; siç kishim debat për sheshin 'Skënderbej', ja çmimet që po merr sot; siç kishim debat për Bulevardin e Ri, ja aksi i hapur për Tiranën e 50 viteve në vazhdim.

Ri, ja ku është sot; siç kishim debat për sheshin 'Skënderbej', ja çmimet që po merr sot; siç kishim debat për Bulevardin e Ri, ja aksi i hapur për Tiranën e 50 viteve në vazhdim. Ashtu do të kemi edhe një teatër të ri, do të kemi një Piramidë të

re. Vënia dorë në qytet sjell progres, ndryshim, modernizim dhe prosperitet për Tiranën", theksoi Veliaj. Ai solli në vëmendje shembujt e mëparshëm të disa prej projekteve të nisura në kryeqytet, të cilat hasën rezistencë, por sot janë ndër më

të vlerësuara. "E di që do kemi gjithmonë debate për punët e mëdha në Tiranë. Mbjat mend përpara 3 vitesh kur sapo morëm mandatin për të qeverisur dhe për ta ndryshuar Tiranën, për ta kthyer në punë, një nga ankesat ishte: S'kemi shesh, s'kemi pazar, s'kemi teatër, s'kemi bulevard. Tani që fillojmë t'i bëjmë këto punë, del një tjetër lloj lëvizjeje, e cila thotë: Mos ma prek liqenin, mos ma prek parkun, mos ma prek bulevardin, mos ma prek sheshin, mos ma prek pazarin, mos ma prek teatrin. Pyetja është: Nëse duam ndryshim! Por, si bëhet ndryshimi nëse s'i prekim



gjërat me dorë?", u shpreh Veliaj teksa theksoi se Tirana sot është padyshim qyteti më i vlerësuar dhe me më shumë çmime në Ballkan. Veliaj deklaroi se kur të gjithë bashkëpunojnë dhe nuk pengojnë njëri-tjetrin duke humbur kohë, gjërat ercin përpara. "Fakti se edhe në vendin tonë e ekonomitë modeste arrijmë

ta ngremë reputacionin e qytetit, do të thotë se gjërat i kemi vetë në dorë, kur bashkëpunojmë ecim përpara. Kur pengojmë njëri-tjetrin, sigurisht që humbasim kohë të çmuar. Unë jam i bindur se Tirana nuk ka më kohë për të humbur, ndaj do të vazhdojë me modernizimin e qytetit", u shpreh kryebashkiaku.

Bashkia e Tiranës ka nisur projektin për rehabilitimin e Unazës së Mesme, me qëllim përmirësimin e sistemit të qarkullimit për automjetet dhe shtimin e korsive për biçikleta. Gjatë inspektimit të punimeve që po kryhen në disa segmente të Unazës, pranë Njësisë nr7 në kryeqytet, kreu i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj theksoi se ndryshimi vjen pasi vihet dorë dhe shprehu bindjen se Tirana do të vazhdojë me këtë ritëm të modernizimit edhe për Teatrin e ri Kombëtar dhe Piramidën. "E patëm një alternativë që s'prekte gjë me dorë dhe flinte gjumë. E kishim katër vjet dhe e dimë si përfundoi. Jam shumë i bindur se Tirana do të vazhdojë ritmin e modernizimit. Siç kishim debat për Parkun e Liqenit, ja ku është sot; siç kishim debat për Pazarin e

Ornela Manjani

Nënkryetarja e Komisionit parlamentar të Ekonomisë, Jorida Tabaku ka akuzuar qeverinë se e ka kthyer dhënien e koncesioneve dhe tenderëve me ofertë të pakërkuar në një praktikë pune, duke eliminuar garën mes kompanive. Gjatë mbledhjes së të hënës, Tabaku tha se nga 7 projektet e paketës "1 miliard" janë dhënë pikërisht në këtë formë. Forma e ofertës së pakërkuar është kundërshtuar edhe nga kreu i komisionit, Erjon Braçe, i cili tha se në shtator do të propozojë heqjen e saj nga ligji aktual. Sipas tij, aktualisht numërohen mbi 319 kontrata të dhëna pa garë, çka sipas tij po shkatërrojnë vendin. Aktualisht, Ministria e Financave ka nxjerrë për konsultim publik disa ndryshime në ligjin aktual, duke synuar rritjen e kontrollit gjatë fazës së përgatitjes së projekteve të koncesionit/PPP, për të mbajtur nën kontroll angazhimet fiskale të marra nga Autoritetet Kontraktuese, me qëllim minimizim e impaktit të tyre në buxhet.

RISHIKIMI I LIGJIT

Në shtator, qeveria do të rishikojë ligjin për dhënien me koncesion duke përfshirë të gjitha ofertat e pakërkua, një kërkesë që e përsëritur edhe nga FMN. Kryetari i Komisionit Parlamentar të Ekonomisë, Erjon Braçe bëri të ditur

Qeveria do të rishikojë në shtator ligjin për koncesionet

Koncesionet pa garë, Braçe: Mbi 319 kontrata po shkatërrojnë vendin

Pastrimi i parave, rastet do shqyrtohen në Komisionin e Ekonomisë

nismën pas një debati të zhvilluar me opozitën. Deputetja e PD, Jorida Tabaku akuzoi mazhorancën për abuzime me projektet Partneritet Publik Privat. "Si ka mundësi kur në të gjitha koncesionet që janë dhënë në shëndetësi janë me ofertë të pakërkuar, çfarë garë është kjo? E njëjta gjë ka ndodhur me çdo PPP me koncesionet. Unë kam publikuar në këtë komision edhe tendera për Prokurime Publike, një në tre tendera jepet pa garë. Ky është një shqetësim i madh, por qeveria hesht dhe nuk kthen përgjigje", - tha Tabaku. Por, Erjon Braçe deklaroi se diskutimet do të nisnin në sesionin e ardhshëm. Sipas tij, ligji aktual është ai i miratuar prej qeverisë "Berisha". "Për mua, ndryshimet në ligjin për koncesionet dhe PPP duhet të nisin dhe të mbarojnë me eliminimin e formës së gjetur



Komisioni i Ekonomisë

të PPP në ligjin që u trashëguar prej jush, propozim i pakërkuar. Sipas atij ligji, janë një mori me çështje dhe koncesione që janë dhënë në të shkuarën dhe që po jepen edhe tani", - tha Braçe.

PASTRIMI I PARAVE

Kreu i Komisionit Parlamentar të Ekonomisë dhe Financave i kërkon mazhorancës, që deputetët e saj të specializuar të diskutojnë në këtë komision çështjen e

pastrimit të parave, pas qindra denoncimeve të bëra publike pak ditë më parë nga Prokurorja e Përgjithshme, Arta Marku. Erjon Braçe ka deklaruar se çështja e pastrimit të parave në Shqipëri duhet diskutuar jo vetëm në Komisionin Parlamentar të Sigurisë Kombëtare, por edhe në atë të Ekonomisë dhe Financave. Kreu i këtij komisioni, Braçe e ka bërë këtë kërkesë ditën e sotme, teksa ka mbledhur këtë komision, ku ka deklaruar se shumë shpejt do i dërgojë kryetarit të Kuvendit një kërkesë për rikthimin e praktikës, për të raportuar në këtë komision nga ana e institucioneve, se çfarë po ndodh në vend për këtë çështje. Braçe theksoi se këtë kërkesë do ia dërgojë shumë shpejt kreut të Kuvendit, që të bëhet transparentë se çfarë po ndodh në vend, apo çfarë kanë zbuluar institucionet përkatëse.

Kontrollet në bregdet, Tatimet: 6.9 mln lekë gjoha në veri

Hetimi Tatimor po vijon me kontrollet dhe verifikimin e subjekteve që ushtrojnë veprimtari ekonomike në sektorin e turizmit në të gjithë vendin. Më konkretisht, strukturat e specializuara të Drejtorisë së Hetimit Tatimor Rajoni Verior po i përqendrojnë veprimet e tyre në zonat turistike të qarkut Shkodër e Lezhë, nga Veli-poja në Tale e Patok, si dhe në zonat malore të Valbonës, Razmës, Thethit etj. Që nga data 22 qershor e në vazhdim, nga kjo drejtori u verifikuan në total 397 subjekte, nga të cilat për 186 subjekte u morën masa, me një vlerë prej rreth 6.9 milionë lekësh. Më konkretisht: "Për moslëshim kuponin hera parë" janë konstatuar 34 shkelje; për "punonjësit të padeklaruar" janë konstatuar 28 shkelje; për "mall pa faturë tatimore" (rivlerësim dhe ndryshim përgjegjësie) janë konstatuar 25 shkelje, për "mosmbajtje të pajisjes fiskale në gjendje pune" janë penalizuar 14 subjekte, për "shitje pa faturë" janë penalizuar 12 subjekte, ndërsa 19 subjekte kanë rezultuar të parregjistruara në organet tatimore. Gjithashtu, edhe nga Drejtoria e Hetimit Tatimor Rajoni Jugor po ushtrohen kontrollet të vazhdueshme.



giz

ANNOUNCEMENT

Private Vocational Training Providers – Call for (i) Expressions of Interest and (ii) Proposals

The GIZ Program for "Sustainable Economic and Regional Development, Employment Promotion and Vocational Education and Training" in Albania (GIZ ProSEED), implemented on behalf of the German Federal Ministry of Economic Cooperation and Development, under the component of Technical Vocational Education & Training (VET), will cooperate with private vocational training providers in the country with the aim to scale-up VET interventions, complementary to the courses offered by public VET providers.

In this respect, the programme is conducting a Call for (i) Expressions of Interest and (ii) Proposals from **23 July – 20 August 2018**, which shall help to identify private training providers that offer Vocational Training (VT) in line with the requirements below:

- Under each contract, the private training providers, will offer several training courses. The training duration of each course per batch should be at least 1 month.
- The training courses under each contract should target altogether 50-150 young people (19-34 years) in total. 40% of the participants are to be female and 30% are to be returning migrants from EU Member States.
- The courses should reflect the following prioritized sectors: ICT, tourism, agro-processing, textile & footwear and innovative/creative crafts; but are not necessarily limited to these sectors, if justified based on local labour market needs and employment prospects.
- The courses should be demand-driven and include work-based learning based on local labour market needs and eventually aim at employment.
- The proposals should reflect and include information on job placement mechanisms to guarantee employment of minimum 50% of the participants.
- There is no limitation in terms of geographical location, though priority will be given to (rural) locations where public/private vocational training is non-existent or very limited.
- The overall implementation timeframe for the interventions is up to 9 months.

The proposals that are to be selected through this call shall receive financial support ranging between 30,000 – 50,000 EURO (equivalent in ALL). The number of contracts is flexible until the overall programme budget of EUR 400,000 assigned for this activity is allocated.

Selection Procedure:

First step: All (i) Expressions of Interest and (ii) Proposals received by applicants will be evaluated based on the eligibility and technical criteria described in the evaluation grid.

Second Step: The potentially qualified candidates will be invited for interviews and required to submit a budget proposal.

Third Step: Contracts will be awarded to the companies with best technical and financial offer.

Please, send an email to giz-albanien@giz.de, to receive the Proposals format and the Evaluation Grid.

For further questions contact us via email to giz-albanien@giz.de during the period 23 July – 20 August 2018.



giz

Press Notice

To the attention of the general public

Make it in Albania – OPENING OF THE SECOND CALL FOR PROPOSALS

Following its mandate from the German Federal Ministry for Economic Cooperation and Development (BMZ) and in partnership with the Ministry of Economy and Finance (MoEF), the GIZ Program for "Sustainable Economic and Regional Development, Employment Promotion and Vocational Education and Training" in Albania (GIZ ProSEED) under its third component of Social Participation of Marginalized Youth and Minorities is **opening its Second Call for Proposals from 23 July – 21 August 2018**.

The aim of this call for proposals is to financially support local civil society organizations, to implement small-scale projects that strengthen social empowerment and cohesion, and enable the target group to engage actively, in line with their interests and capabilities, to find common solutions to improve their-, and their respective communities' social and economic situations.

All CSOs registered in Albania with at least 2 years of relevant experience and proven record in youth empowerment and social cohesion are invited to submit proposals under this call for proposals.

The 10 envisaged proposals to be selected through this competitive call shall receive financial support in the amount between 10,000 – 20,000 EURs (equivalent in ALL).

The proposed interventions submitted by the local CSOs may take different shapes and may include activities that strengthen the interaction between different groups of youth, activities that contribute to the development of life skills, cultural and sports activities, as well as activities that foster the inclusion of minorities, women, persons with disabilities and migration returnees. The long-term outcome of these activities should aim at increasing the target group's social capital and future employability prospects.

In order to submit a proposal for participation in this call, it is necessary to consult the Application Guidelines that may be obtained by it through the ProSEED Facebook page. The Application Guidelines state the defined objectives, and requirements to be complied with and provide detailed information on the procedures for selection. Interested local CSOs can find all the official templates for submitting proposals under this call annexed to these guidelines. Applying CSOs shall submit their applications only electronically to makeitalbania@giz.de. All applications must be submitted in English language.

For further questions and clarifications on the Application Guidelines, please contact us via email to: makeitalbania@giz.de during the period 16 – 20 of July 2018, prior to the opening of the call. After this period GIZ ProSEED shall not answer any enquiry related to the call.

The deadline for the submission of the proposals is 21 August 2018, 16:00h.

DIBËR - Policia e Dibrës ka zbardhur në kohë rekord grabitjen në banesën e Adraman Selishtës, ku gjatë përlëshjes mbeti i plagosur me armë zjarri djali i shtëpisë, Arsen Selishta. Pas hetimeve të kryera, blutë arrestuan një ditë pas ngjarjes së ndodhur në fshatin Brezhdan, dy autorët e krimit. Bëhet fjalë për Ilir Shinin dhe Gaetano Hasin. Ndërkohë, mësohet se gjatë kontrollit të ushtruar në banesën e këtij të fun-



Plagosën me armë zjarri të zotin e shtëpisë, arrestohen dy grabitësit me jelek antiplumb

dit u gjetën dhe u sekuestruan një jelek antiplumb, 506 fishekë, si dhe disa veshje që dyshohen se janë përdorur nga autorët gjatë grabitjes. "Në përfundim të veprimeve të kryera janë identifikuar dhe arrestuar në flagrancë dy autorët e dyshuar të kësaj ngjarje: Gaetano Hasi, 35

vjeç, banues në fshatin Brest i Poshtëm/Kastriot, Dibër (veprat penale "Vjedhje me armë" kryer në bashkëpunim dhe "Mbajtje pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit" si dhe Ilir Shini, 31 vjeç, banues në fshatin Brest i Epërm/Kastriot, Dibër (ve-

pra penale "Vjedhje me armë", kryer në bashkëpunim"). Këta shtetas me bashkëpunim menjëri-tjetrin dyshohen se më datë 15.07.2018, rreth orës 03:30, të maskuar dhe nën kërcënimin e armës kanë vjedhur banesën e shtetasit A.S. 53 vjeç, banues në fshatin Brezh-

dan, ku gjatë grabitjes ka mbetur i plagosur me armë zjarri shtetasi E.S., 35 vjeç", thuhet në njoftimin zyrtar të policisë. Ndërkaj, blutë në bashkëpunim me prokurorinë Dibër vijojnë hetimet për zbardhjen dhe dokumentimin ligjor të rasteve të tjera të vjedhjeve ku dyshohet se këta shtetas janë autorë. Materialet hetimore do t'i referohen Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Dibër për hetime të mëtejshme.

"Do kërkojmë drejtësi deri në vdekje, çështjen do e çojmë në Strasburg"

Vdekja në paraburgim, prokuroria nuk pranon riekspertim të organeve të Enea Ftoit

Prindërit: Djali u dhuna barbarisht nga policia, duan të fshehin të vërtetën e ngjarjes

Mariglen Biti

KORÇË

Prokuroria e Korçës nuk ka pranuar riekspertimin e organeve të Enea Ftoit, i cili ndërroi jetë dy muaj më parë në ambientet e komisarariatit të këtij qyteti. Ndonëse familjarët e 27-vjeçarit kërkuar që trupi të zhvarrohej dhe më pas t'i nënshtrohej një tjetër ekspertizë, kjo kërkesë është refuzuar nga organi i akuzës. Ndërkohë, familjarët kanë deklaruar se do ta çojnë çështjen në Gjykatën e Strasburgut derisa të zbardhet e vërteta e vdekjes së djalit të tyre. Riekspertimi i organeve u kërkuar nga avokatët e familjarëve, pasi nuk pranuan ekspertizën mjeko-ligjore, sipas së cilës Enea Ftoi kishte humbur jetën për shkak natyror, duke kërkuar një tjetër ekspertim dhe nga tjetër grup ekspertësh. Mësohet se prokuroria e ka hedhur poshtë këtë kërkesë me arsyetimin se nuk ka shkelje të rregullores për të marrë në konsideratë riekspertimin. Menjëherë pas përgjigjes negative të prokurorisë, kanë reaguar familjarët e 27-vjeçarit. Ata akuzuan prokurorinë e Korçës se po mundohet të fshehtë të vërtetën. "Prokuroria nuk pranon ekspert të jashtëm. Nuk e di pse refuzojnë kërkesën tonë, kur e dinë mirë se djali është dhunuar barbarisht. Ne kemi të gjitha fotot e dhunës. Çfarëdo më prokuroria nga ne. Përse nuk marrin për bazë provat që kemi ne, por marrin për bazë policinë që e vrau dhe duan ta mbulojnë? Unë do ta kërkoj deri në vdekje të drejtën e tim biri", u shpreh nëna e Enea Ftoit. Ndërsa, babai i viktimës tha i dëshpëruar: "Po mundohen të fshehin të vërtetën për vdekjen së djalit. Kemi prova që Enea është dhunuar nga policia në ambientet e Komisarariatit të Korçës. Kemi video dhe foto, që provojnë dhunën barbare të policisë. Në rrobat e Eneas, tek atletet kemi gjetur gjurmë gjaku. Kërkojmë ekspert të huaj, jemi të bindur që Enea ka vdekur nga dhuna. Do ta kërkojmë të vërtetën deri në Gjykatën e Strasburgut".



27-vjeçari Enea Ftoi

NGJARJA

Enea Ftoi ndërroi jetë më 17 maj të këtij viti në ambientet e paraburgimit të Korçës, ku kishte tre ditë që qëndronte pasi ishte ndaluar për "vjedhje me dhunë". Ftoi diën kur ndodhi ngjar-

ja, duhej të dilte në sallën e gjyqit për akuzën e vjedhjes që rëndonte ndaj tij. Ndonëse familjarët e prisnin atë në sallën e gjyqit, ata u njoftuan për ngjarjen e rëndë. Fill pas ngjarjes, familjarët e viktimës hodhën akuzë të rën-



Prindërit e viktimës



da për policinë, pasi kanë dyshime se djali i tyre është dhunuar në paraburgim, që i ka shkaktuar edhe vdekjen. Po ashtu familjarët akuzojnë punonjësin e policisë, Arqile Ropi, pasi pretendohet se ai ka ushtruar dhunë ndaj

27-vjeçarit. Mes të tjerash familjarët deklarojnë se disponojnë fakte dhe prova që Enea Ftoi është dhunuar dhe më pas vrarë. Ata kanë bërë foto dhe video, ku duken qartë sipas tyre shenjat në trupin e tij.

Sekuestrohet gomonia me rreth 300 kg kanabis në Bari, mediat italiane: Vinte nga Shqipëria

ITALI - Policia italiane ka sekuestruar një gomone me rreth 300 kg kanabis në brigjet e Barit. Në pranga ka përfunduar trafikanti, një italian rreth 26 vjeç nga Brindisi. Pas kapjes dhe kontrollit të detajuar të gomones, policia e vendit fqinj ka gjetur të fshehur në disa tuba sasinë e konsiderueshme të lëndës narkotike. Media italiane 'Ansa' raporton se gomonia me drogë ka ardhur nga Shqipëria dhe, nëse do hidhej në treg, do kapte vlerën e 3 milionë eurove. Ndërkaj, policia e vendit



Droga e sekuestruar në Itali

fqinj vijon hetimet për identifikimin dhe kapjen e trafikantëve të tjerë të përfshirë

në këtë aktivitet kriminal si dhe saktësimin e origjinës së lëndës narkotike.

3

MLN EURO

Pas kapjes dhe kontrollit të detajuar të gomones, policia e vendit fqinj ka gjetur të fshehur në disa tuba sasinë e konsiderueshme të lëndës narkotike. Media italiane 'Ansa' raporton se gomonia me drogë ka ardhur nga Shqipëria dhe nëse do hidhej në treg do kapte vlerën e 3 milionë eurove.

SHKURT

Italianit i sekuestrohen 4 llogari bankare me 293 mijë euro

VLORE - Në vijim të punës së saj, policia e Vlorës në bashkëpunim me prokurorinë e këtij rrethi dhe Drejtorinë Hetimore Qendrore, në kuadër të procedimit penal nr.1263 të vitit 2018, kanë vendosur sekuestro preventive mbi 4 llogari bankare të shtetasit italian V.L.. Mësohet se vlera monetare e sekuestros preventive të llogarive bankare është 293.000 euro. Shtetasi V.L., dyshohet për kryerjen e veprës penale të pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale.

Mbytet në Shëngjin, 30-vjeçari nga Elbasani

LEZHË - Një 30-vjeçar nga Elbasani është gjetur i pajetë mëngjesin e djetshëm në Shëngjin. Sipas policisë, rreth orës 09:45, në vendin e quajtur "Skallierat" pranë portit të Shëngjinit është gjetur i mbytur në det shtetasi M.L., banues në Elbasan. Kanë qenë kallimtarët e rastit që kanë sinjalizuar policinë. Nuk dihet ende se si ka ndodhur ngjarja, apo nëse 30-vjeçari ka qenë pushues në plazhin e Shëngjinit. Grupi hetimor po punon për zbardhjen e plotë të ngjarjes.

Shoqërohen 30 persona. Asnjë drejtues policie në varrimin e ish-efektivit Bërcana

Senad Nikshiqi

SHKODËR

Një ditë pas ekzekutimit mafioz të ish-efektivit të policisë, Boran Bërcana dhe bashkëjetueses së tij 25-vjeçare, Silvana Ndoci, policia ka zbardhur detaje të reja në lidhje me krimin e dyfishtë që tronditi banorët e Shkodrës dhe jo vetëm. Sipas hetuesve të çështjes, autor i ngjarjes së rëndë që ndodhi rreth orës 01:15 të mëngjesit të së dielës në lagjen "Naim Gjylbegu" të qytetit verior është një person i vetëm, i cili ka qenë i pamaskuar dhe me kapele në kokë. Mësohet se ekzekutori ka qëlluar me breshëri automatiku mbi dy të rinjtë duke i lënë të vdekur në vend (brenda në makinën e viktimave) dhe më pas është larguar me një automjet tip "Benz C Class", që u gjet disa orë më vonë e djegur në Dobracë të Ri, në zonën e "By Pass"-it të Shkodrës që është në ndërtim e sipër. Në lidhje me krimin e dyfishtë, të cilit i mbijetoi mrekullisht fëmija 2-vjeçar i çiftit janë shqetësuar dhe marrë në pyetje 30 persona. Mësohet se të gjithë kanë deklaruar se çifti në fjalë kishte probleme, të paktën në dijeninë e tyre. Sipas burimeve të mësipërme, dyshohet që ngjarja mund të ketë marrë shkas për shkak të detyrës që ka bërë 30-vjeçari, ose të ndonjë konflikti të mundshëm me persona të tjerë. Ndërsa, nuk përjashtohet mundësia që vrasja e dyfishtë të jetë kryer për larje hesapsh. Policia dhe prokuroria e Shkodrës janë duke hetuar intensivisht për zbardhjen e kësaj ngjarjeje, e cilësohet të jetë ndër më të rëndat të kryera në Shkodër gjatë 28 viteve të fundit. Ndërkaq, dje u përcollën në banesën e fundit Boran Bërcana dhe Silvana Ndoci. Në ceremoninë mortore nuk ishte i pranishëm asnjë zyrtar i lartë i Policisë së Shtetit për t'i dhënë lamtumirën ish-efektivit të vrarë.

HETIMET
Sipas policisë, në vrasjen makabre të së dielës ka qenë një autor, i cili nuk ka qenë i maskuar. Ai ka qëlluar 23

Vrasja në Shkodër, autori qëlloi çiftin pasi u sigurua se plumbat s'kapnin djalin 2-vjeçar

Policia: Ekzekutori ishte i vetëm dhe i pamaskuar, u largua me automjetin e vjedhur në Tiranë



Viktimat Boran Bërcana dhe Silvana Ndoci



Ceremonia e varrimit

DJALI 2-VJEÇAR

Djali i imitur i çiftit dyshohet se ka qenë në gjumë në sediljen e pasme të "Benz"-it kur ka ndodhur vrasja. Ndërsa, efektivët e policisë e kanë gjetur atë në prehrin e nënës të mbuluar nga gjaku. 2-vjeçari ka qëndruar për mbi 5 orë brenda makinës, pranë trupave të pajetë të prindërve. Pas këqyerjes së vendit të ngjarjes, policia ka gjetur 23 plumba që janë lëshuar në drejtim të çiftit. Fatmirësisht, fëmija i vogël ka shpëtuar pa marrë asnjë plumb.

APELI I MOTRËS SË VIKTIMËS

Momenti më prekës në ceremoninë mortore ishte nxjerrja e dy arkiveve nga shtëpia e familjes Bërcana. Të gjithë kanë përjetuar dhimbje të madhe kur kanë parë trupat e dy të rinjve që përcilleshin për në banesën e fundit. Ishte tejet e vështirë për familjarët dhe të afërmit që në këtë ditë zie për ta të jepnin një mesazh qoftë për pjesën tjetër të shoqërisë, por edhe strukturat policore. Gjithsesi, motra e Silvana Ndoci, Antoneta Ndoci kërkoi zbardhjen e plotë të vrasjes dhe kapjen e vrasësit.

herë në drejtim të çiftit me armën automatike "MP5". Mësohet se ekzekutori i çiftit ka futur dorën brenda mjetit tip "Benz" me targë AA 006 HA dhe pasi është siguruar se plumbat nuk kapin fëmijën 2-vjeçar, ka qëlluar me breshëri mbi ish-policin dhe bashkëjetuesen e këtij të fundit, Silvana Ndoci. Po të njëjtat burime thanë se makina që u gjet e djegur

është e vjedhur. Mjeti tip "Benz C Class" është vjedhur në Tiranë, ndërsa pjesët e makinës janë marrë në vende të ndryshme dhe mjeti është montuar. Më pas autori ka kryer krimin me të. Pamjet filmike të sekuestruara në të gjitha subjektet e mundshme janë dërguar në Tiranë për një ekspertizë më të detajuar, ndërsa pohohet se është i regjistruar momenti kur

Bërcana dhe Ndoci janë qëlluar me breshëri automatiku, që u gjet në automjetin e djegur. Deri më tani për këtë vrasje janë shoqëruar 30 persona, 12 prej të cilëve kishin lidhje të afërta me çiftin e ekzekutuar. Të gjithë kanë mohuar se çifti në fjalë kishte probleme, të paktën në dijeninë e tyre. Ndërsa, dëshmitarët (banorët e pallatit ku jetonte çifti prej 8 muajsh me

qira) kanë deklaruar se nuk kanë dëgjuar krismë dhe nuk kanë parë asgjë. Pavarësisht sekuestrimit të pamjeve të kamerave të sigurisë, mësohet se ngjarja është e vështirë për t'u zbardhur për shkak të errësirës dhe djegies totale të makinës që u përdor në këtë krim.

VARRIMI I ÇIFTIT

Familjarë, të afërm, miq dhe shoqëria kanë marrë pjesë në ceremoninë mortore të ish-policit Boran Bërcana dhe bashkëjetueses së tij, Silvana Ndoci. Trupat e pajetë dolën nga banesa e familjes Bërcana përballë shkollës së ndërtimit në Shkodër. Në ceremoninë mortore morën pjesë vetëm disa efektivë policie, me të cilët Bërcana kishte punuar në policinë ven-

dore të Shkodrës deri para pak muajsh. Ndërkohë, munguan drejtuesit e policisë së Shkodrës si dhe nuk ishte i pranishëm asnjë zyrtar i lartë i Policisë së Shtetit. Momenti më prekës në ceremoninë mortore ishte nxjerrja e dy arkiveve nga shtëpia e familjes Bërcana. Të gjithë kanë përjetuar një dhimbje të madhe, duke parë trupat e dy të rinjve që përcilleshin për në banesën e fundit. Ishte tejet e vështirë për familjarët dhe të afërmit që në këtë ditë zie për ta të jepnin një mesazh, qoftë për pjesën tjetër të shoqërisë, por edhe strukturat policore. Gjithsesi, motra e Silvana Ndoci, Antoneta Ndoci fare shkurt kërkoi zbardhjen e plotë të vrasjes dhe kapjen e vrasësit.

Shkak, pasuria e kontakti me të dënuar

Vetingu, shkarkohet anëtar i Gjykatës Kushtetuese, Gani Dizdari

TIRANË - Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka shkarkuar dje nga detyra gjyqtarin e Gjykatës Kushtetuese, Gani Dizdari, pasi gjatë procesit të verifikimit në kuadër të vetingut rezultoi me probleme sa i takon pasurisë dhe integritetit të figurës. Për vlerësimin e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese, KPK-ja u bazua në dy kritere: atë të figurës dhe pastërtisë të figurës. Tru-



pa gjyqese vlerësoi se gjyqtari Dizdari ka kontakte të pabërshatshme dhe probleme me pasurinë. KPK evidentoi burime të pamjaftueshme për një pjesë të pasurisë së gjyqtarit si dhe mungesë burimesh të ligjshme dhe pasuri të padeklaruara në emër të vajzës. E para ka të bëjë me nipin e tij A.L., i dënuar vite më parë për "ushtrim të ndikimit të paligjshëm te personat që ushtrojnë funksione publike". Bëhet fjalë për një

Raporti i ILDKPI: S'ka fshehur pasurinë

Përballet me KPK-në gjyqtari i Gjykatës së Lartë, Artan Zeneli

TIRANË - Anëtar i tretë i Gjykatës së Lartë, Artan Zeneli është përballur dje me Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, ndërkohë që është pjesë e listës prioritare të vetingut, pasi kandidon për Këshillin e Lartë Gjyqësor. Seanca dëgjimore në KPK me gjyqtarin Zeneli ka nisur në mesditë, ndërsa ai nuk u përfaqësua me avokat. Trupi gjyqësor drejtohet nga Etleda Çiftja dhe ka si anëtarë Xhensila

Pinen dhe Valbona Sanxhak-tarin. Sipas KPK, hetimi është kryer për komponentët e figurës dhe pasurisë. Një fakt që doli në seancë ishte se gjyqtari i është revokuar viza për në SHBA më 26 janar të vitit të kaluar. KPK thotë se këtë fakt nuk e ka deklaruar tek formulari për kontrollin e figurës. Ndërkohë për sa i përket raportit të ILDKPI, pasuria e deklaruar nuk ka fshehje. Artan Zeneli e ka filluar karrierën në vitin 1991



si gjyqtar, është shkëputur për një dekadë për të ushtruar profesionin e avokatit dhe është rikthyer sërish në sistem në vitin 2009. Në vitet 1991-1999 ai ka punuar si gjyqtar në Krujë dhe në Tiranë. Në vitin 1999, Zeneli është larguar me dëshirë e tij për t'u bërë avokat, profesion të cilin e ka ushtruar deri në vitin 2009.

Dosjet e viteve 1993-2008, formulari-tip për informim në lidhje me ecurinë e vendimeve

Ornela Manjani

Agjencia e Trajtimit të Pronave publikon listën me 10 mijë dosje ish-pronarësh, që janë në proces shqyrtimi nga kjo agjenci. Kërkesit janë në qarkun e Korçës. Në listën e përditësuar jepet numri i dosjes dhe data e aplikimit, gjeneralitetet e kërkesit, sipërfaqet e njohura për kompensim, dosjet për pronarët që kanë marrë vendim negativ dhe dosjet që duhet të plotësohen. Dosjet janë të viteve 1993 deri në vitin 2008. Agjencia e Trajtimit të Pronave ka vënë në dispozicionin të pronarëve formularin-tip, "Informacion në lidhje me ecurinë e dosjes", i cili duhet të plotësohet dhe të dorëzohet në 'Agjenci' për t'u njohur me fazën në të cilën ndodhet shqyrtimi i saj. Agjencia Trajtimit të Pronave është e detyruar që brenda 15 ditëve nga momenti i dorëzimit të kërkesës t'i kthejë përgjigje pronarit në lidhje me ecurinë e dosjes.

FORMULARI

Formulari i aplikimit për informacion në lidhje me ecurinë e dosjes është i ndarë në tri seksione. Aplikanti duhet të plotësojë gjen-

Pronarët në Korçë, ATP merr në shqyrtim 10 mijë dosje

Problematikat, procedurat për t'u njohur me ecurinë e shqyrtimit

DOKUMENTACIONI QË DUHET TE PARAQISNI

- Formulari-tip
- Fotokopje e kartës së identitetit
- Kopje vendimi nga ish-KKP/AKKP (nëse ka)
- Dokumente të tjera

eralitet, adresën dhe të jetë i pajisur me mjet identifikimi në momentin e aplikimit. Në seksionin e dytë duhet të jetë përshkruar në mënyrë të saktë se në lidhje me çfarë kërkon informacion pala e interesuar, në këtë rast pronari që ka aplikuar për kthim e kompensim prone. Dhe në seksionin e fundit janë të specifikuar pesë dokumentet që duhet të disponojë pronari në momentin e aplikimit.

APLIKIMI

Për t'u njohur me ecurinë e dosjes, subjekti duhet të plotësojë dhe të paraqesë dorazi ose me postë pranë ATP-së kërkesën përkatëse me shkrim për informim në lidhje me ecurinë e dosjes, fotokopje të kartës së identitetit, dëshmi trashëgimie

dhe prokurë të posaçme. Në faqen zyrtare të ATP-së mësohet se subjekti plotëson kërkesën me shkrim për informim në lidhje me ecurinë e dosjes pranë Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun, në 'Agjenci'. Më pas, kërkesa i kalon zyrës së protokollit, e cila pasi e protokollon, ia dërgon të gjitha kërkesat e ardhura drejtorit të përgjithshëm. Kreu i AKKP-ës ia delegon kërkesat sek-

torit përkatës për ndjekje dhe zbatim. Më pas, sektori përkatës përgatit informacionin e kërkuar dhe njofton subjektin. Në përfundim të shqyrtimit, subjekti paraqitet pranë zyrave të ATP-së për të tërhequr shkresën e kthimit të përgjigjes në lidhje me ecurinë e dosjes ose i dërgohet me postë, si pas kërkesës. Aplikimi për kërkesën për informim mbi dosjen nuk ka kosto.

Formulari i informacionit për ecurinë e dosjes, i cili përfshin fjalëkryq, informacion personal, adresë, kontakt, dhe informacione specifike për dosjen.

KORÇË

Nr./Dosjes	Rrethi	Emri (Subjekti kërkuar)	Atesia 2	Mbiemri (Subjekti kërkuar)	Sip. E Njohur/ Mosnjohje M2	Problematika
1097	KORÇE	FORI		PALLOCI		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1099	KORÇE	SAMI		MUAXHIRI		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1101	KORÇE	EDMOND		MAKSUTI		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1102	KORÇE	UGOR		ARRA		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1105	KORÇE	STAVRI		DEDO		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1104	KORÇE	ROBERT		KUQUAI		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1107	KORÇE	MAQO		UGORI		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1109	KORÇE	SPIRO		TOMCO		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1111	KORÇE	NAIM		KAJO		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1113	KORÇE	THEODHORA		NACI		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1116	KORÇE	VIKTOR		BRENIA		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
475	KORÇE	MIRGEN		SHKOZA	51000	
501	KORÇE	PANDI	LLAMBI	DHESPO	29500	
34	KORÇE	DOROTHEA		QAFZEI	843 / MOSNJOHJE 2000	
	KORÇE	KRISTAQ		THANA	9350 MOSNJOHJE 1650	
89	KORÇE	BARDHI		CELO	805 HA MOSNJOHJE 598 HA	

Nr./Dosjes	Rrethi	Emri (Subjekti kërkuar)	Atesia 2	Mbiemri (Subjekti kërkuar)	Sip. E Njohur/ Mosnjohje M2	Problematika
54	KORÇE	SERVETE		EMANOIL	427 DT 21.04.2008	
139	KORÇE	BESNIKE		SEJDARASI	MOSNJOHJE 500	
110	KORÇE	XHAFERR		FERO	8483	
680	KORÇE	FLORIAN		VILA	MOS NJOHJE 318500	
671	KORÇE	GURALI		ISADEMI	MOSNJOHJE 16552	
673	KORÇE	ALES		MANUSHI	MOSNJOHJE 1511	
664	KORÇE	ALI		HASKA	MOSNJOHJE 7100	
668	KORÇE	HYNSI		AGOLLI	MOSNJOHJE 13960	
683	KORÇE	PERPARIM		SHUKULLI	MOSNJOHJE 4500	
663	KORÇE	SELMAN		TEROLLI	MOSNJOHJE	
655	KORÇE	BASHKIM		TABAKU	MOSNJOHJE 2875	
686	KORÇE	EMIN		ZHURKA	MOSNJOHJE 75	
629	KORÇE	REXHEP		SHEMBITRAKU	MOSNJOHJE 41200	
682	KORÇE	ADEM		AGOLLI	MOSNJOHJE 1000	
28	KORÇE	ASTRIT	XHAVIT	BLACERI	480	
347	KORÇE	VILSON		TONA	7311	
182	KORÇE	ANDREA		PENGU	156	
94	KORÇE	KASEM		DUCI	23490	
96	KORÇE	NASIRDA		SHYTI	108000	
150	KORÇE	QAMLI		BLACERI	12200	
138	KORÇE	SHKELQIM		MUSLARI	12794	
142	KORÇE	DHIONIS		KOTMILA	15250	
188	KORÇE	ARSEN		SHUSHI	16500	
372	KORÇE	MARIGLEN		OCKA	67000	
196	KORÇE	CELNIK		SHYTI	4845	
152	KORÇE	ALI	QAZIM	DULE	3646	
314	KORÇE	BAJRAMI		MALELLARI	8428	
283	KORÇE				4317	
	KORÇE				4317 140 MOSNJOHJE	
316	KORÇE	BASHKIM		MYRTEZA	2/3 E SIP 222500 / MOSNJOHJE	
894	KORÇE	ZHULI		BREGASI	1/3 E 22250	
912	KORÇE	DALLENDYSHJE		SHKEMBI	MOSNJOHJE	
566	KORÇE	LAZAR		TEROVA	MOSNJOHJE 194824	
294	KORÇE	KETI		HORDANI		
272	KORÇE	SHIPRESA		PEPA	MOSNJOHJE 18500	
1195	KORÇE	STAVRI		BEZHANI	246750	
1135	KORÇE	SULEJMAN		QYTETI	57000	
1173	KORÇE	THOMAQ		SHKODRANI	MOSNJOHJE	
758	KORÇE	VASIL		RISTO	MOSNJOHJE 123 000	
742	KORÇE	EDMOND		BRAHIMAJ		
1189	KORÇE	ARISTOTEL		NENE	MOSNJOHJE 54500	
771	KORÇE	JOVAN		LUBONIA	55000	
736	KORÇE	SEUM		ZHILLA	17200	
760	KORÇE	SOKRAT		IMANO	551800	
651	KORÇE	ENDER		NELA	MOSNJOHJE	
128	KORÇE				MOSNJOHJE 156 HA	
282	KORÇE	FLORESHA		GUXHOLLU	MOS NJOHJE 2000	
284	KORÇE	GURI		BICIA	4676	
284	KORÇE	EGEREM		KLOMOLLARI	35658	
16	KORÇE	ERVETE		GIJIRTI	30000	
408	KORÇE	BURBUQE		PETRUSHA	MOS NJOHJE 22000	
123	KORÇE	THIMI		DISHNICA	MOSNJOHJE 18000	
749	KORÇE	LIRIJE		DEMIRI	MOSNJOHJE 23 000	
644	KORÇE	JORGAQ PILI			MOSNJOHJE 78200	
648	KORÇE	PETRAQ		STAVRE	MOSNJOHJE 67400	
1196	KORÇE	STAVRI		BEZHANI	MOSNJOHJE 8000	
246	KORÇE	KOTIRAQ		LARA	MOSNJOHJE 111500	
722	KORÇE	JORGAQ		PAPADHIMI	MOSNJOHJE 1/2 E 8000	
829	KORÇE	RESHAT		KALEMI	MOSNJOHJE 73500	

328	KOLONJE	ANTONIA	PANTAZI		
362	POGRADEC	BURBUQE	SADIKAJ	4034 /MOSNJOHIE 20000	
886	KORCE	GURI	GEGOLLARI	MOSNJOHIE 80250	
54		IVANI	FABERI		
162		ALBERT	QIRAXHI	46000	
531	DEVOLL	FATIME	JAZXHI		
259		ZHANI	BERBERI	12564	
				REZIM KERKESE MOSNJOHIE 12564	
47		THOMA	KALLCO	528990	
605	POGRADEC	BASHKIM	JASHLLARI		
537	KORCE	ILIA	MELKO		
254		MUHAMREM	SHEHU	83250 /MOSNJOHIE 3750	
116		NIZA	LUMI	652 HEK PYLL	
115	POGRADEC	VASILIOS	KONTIS	630	
113	POGRADEC	IDRIZ	MELOOLARI	600	
112	POGRADEC	SKENDER	LEKA	3000	
118		SHEFQET	POCKA	3000	
119		ANESTI	CALE	2000	
109	KOLONJE	BEKHET	NAZARKO	31 HA	
106	KOLONJE	MARRIO	DHINITRI	9690 /MOSNJOHIE 2310	
107		ANILA	CEKICI	MOSNJOHIE TE PRONES 12000	
133		ZINETE	SINA	93.2 HA	
134		PAVILLO	TRAKO	KOMPENSIM 1106	
135	POGRADEC	MIMOZA	BLACERI	400	
132		PANDI	CICO	35800	
131		FATOS	ELEZI	MOSMIRATIMON E KERKESES 9500	
129		SHKLOIM	YENKHA	2580	
128	DEVOLL	SHKLOIM	YENKHA	MOSMIRATIMIN E KULLOTES	
126	POGRADEC	RAFIK	MALELLARI	1080 /MOSNJOHIE 220	
125	DEVOLL	HYSEN	ORHANI	927.5 HA	
139	KOLONJE	ABOYL	FEJZI	5789.96 DY	
149	POGRADEC	HYSEN	BIBA	9188	
148		GERIME	AGOLLI	81999	
144	KORCE	KLER	OKA	9300	
143	POGRADEC	SILVANA	KOLE	440	
142	KORCE	LIDA	TENEQEXHI	MOSNJOHIE 2000	
141	KORCE	ZHANI	PLUKA	10000	
140	KORCE	SOFIKA	TENEQEXHI	1500	
138	KORCE	ROBERT	LLAZO	37000	
137	POGRADEC	VANGJEL	KRISTE	2281	
232		ENVER	TOPALLI	MOSMIRATIMIN E KERKESES	
164	POGRADEC	TEKI	BERBERI	4855	
163	POGRADEC	EMIN	RUSI	4855 /MOSNJOHIE 5000	
155	POGRADEC	STEFAN	BARKA	252.6 HA /MOSNJOHIE 442.4 HA	
	POGRADEC			252.6 HA /MOSNJOHIE 442.4 HA	
	POGRADEC			101500	
151	POGRADEC	ILIRIAN	QIRAXHI	101500	
152	POGRADEC	ROBERT	THEMEU		
154	KORCE	GEZIM	HOXHA	30930	
	KORCE			30930	
186		ELVERTA	LUBONJA	16270	
185		NEXHAT	HALILA	3439	
137	KOLONJE	DRITA	HOXHAJ	95HA	
137	POGRADEC	PANDI	SHIMKE	6849 /MOSNJOHIE 2212	
274	POGRADEC	LINDITA	HABASLLARI	6960	
451	POGRADEC	ELIDA	YENKHA	12000	
227	POGRADEC	ROMEO	ZALLEMI	12000	
167	POGRADEC	PAVILA	NACE	21763.5	
144	POGRADEC	KOMUNITETI ORTODOKS		10000	
167	DEVOLL	MUHAMMET	CIKO	458	
163	DEVOLL	HYSMI	SHEHU	1387	
166	DEVOLL	MERGIN	COLLAJU	845.5	
159	DEVOLL	GEZIM	BERBERI	4632	
91	DEVOLL	MINTOZ	SHEHU	19662	
	DEVOLL			3000	
168	DEVOLL	XHUMA	ESHI	3700	
169	DEVOLL	SHPETIM	PERE	5192	
149	DEVOLL	GJERGJ	KARANXHA	1856	
	DEVOLL			36	
140	DEVOLL	FREDI	BABANI	REZIM KERKESE	
164	DEVOLL	ILO	PINE	92	
160	DEVOLL	LAVER	BERBERI	1245	
150	DEVOLL	LIJAN	SKOTI	1104	
59	DEVOLL	XHEMIL	ESH	800	
10	DEVOLL	BARDHYL	CANE	380	
77	DEVOLL	ZUA	NASTIMI	1000	
78	DEVOLL	SERVET	BODE	478	
78	DEVOLL				
89	DEVOLL	TEKI	MEKA	21.559.295	
11	DEVOLL	SELM	GIJZA	5742	
17	DEVOLL	AJZEN	HISOLLI	188	
86	DEVOLL	GJURI	KELLO	918	
7	DEVOLL	MUHAMREM	MAHO	275	
5	DEVOLL	NEKI	NERO	69	
32	DEVOLL	NEVRUZ	SUBASHI	750	
2	DEVOLL	TRAJKO	KAMBERI	2925	
79	DEVOLL	XHEMAL	COLLAJU	1171	
70	DEVOLL	ZHANETA	POJANI	2000	
84	DEVOLL	BEHIE	KARASKAJ	385	
31	DEVOLL	SEJFULLA	ZAIMI	108	
21	DEVOLL	XHIKO	SHYQYRI	979	
98	DEVOLL	MAQEDON	KARANXHA	1509.2	
71	DEVOLL	VIKTOR	BARBUTA	7739	
92	DEVOLL	RAHIMI	BREGU	3000	
69	DEVOLL	PAIK	MEKA	5242.75	
90	DEVOLL	JANEO	DIMO	18	
69	DEVOLL	GJYLHARE	MULLAJ	1143	
73	DEVOLL	GJYLHARE	MULLAJ	4010	
13	DEVOLL	ERZEN	STARJA	462	
1	DEVOLL	ILIA	MUJZA	50	
93	DEVOLL	BARIQ	AGOLLI	2563	
22	DEVOLL	PANDO	FILO	21.21	
67	DEVOLL	NIKO	SHALLO	2295	
15	DEVOLL	ILIA	KARANXHA	25.4	
9	DEVOLL	TROJKA	GIJOMO	71.4	
72	DEVOLL	REMZI	REVANI	3359	
134	DEVOLL	SHEFIQE	SHURDHO	3753.5	
20	DEVOLL	URIM	PELLUMBII	3139.5	
46	DEVOLL	SYB	NERO	418.5	
33	DEVOLL	XHAVIT	KASEM	300	
6	DEVOLL	KRISTO	KAMBERI	350	
158	DEVOLL	IVANER	KELLO	500	
7	DEVOLL	ENGELS	BARBUTA	31280	
3	DEVOLL	SABRI	FILO	10000	
4	DEVOLL	BARDHYL	CANE	7000	
1	DEVOLL	SHYQYRI	HASAN	12500	
16	DEVOLL	YLVIE	BARBOTA	21997	
2	DEVOLL	ISMAIL	TURABI	5000	
8	DEVOLL	YLVIE	BARBOTA	5600	
6	DEVOLL	SELADIN	AJICE	43500	
44	DEVOLL	BEKTASH	GIJIZA	3000	
45	DEVOLL	BASHKIM	SHEHU	4000	
47	DEVOLL	SALI	KOLLICNAKU		

48	DEVOLL	FERIDE	GAVRI	3000	
49	DEVOLL	THANAS	TEREZI		
	DEVOLL	LUMTURIE	BEILERI		
53	DEVOLL	VALTER	SPAHU		
54	DEVOLL	FATIME	HOXHA		
56	DEVOLL	MYFIT	CANE		
57	DEVOLL	PETRIT	AHMETLLI	1000	
58	DEVOLL	ARIF	HOXHA	1042	
55	DEVOLL	NEHAR	CANE		
55	DEVOLL	VALTER	CANE		
43	DEVOLL	SEIT	MULLA	30000	
21	KOLONJE	ABEDIN	ABEDINI		PA VENDIM
22	KOLONJE	NIJAZI	PASHO		PA VENDIM
72	KOLONJE	FERIE	HAMITI		PA VENDIM
15	KOLONJE	HAUDAR	MUCO		PA VENDIM
130	KOLONJE	ABEDIN	ZHDRO		PA VENDIM
119	KOLONJE	MYRTO	ZHDRO		PA VENDIM
2	KOLONJE	DHIMTER	LULA		PA VENDIM
3	KOLONJE	NEVRUZ	MALUKA		PA VENDIM
114	KOLONJE	SEFER	CANE		PA VENDIM
121	KOLONJE	MYFTAR	MEZINI		PA VENDIM
122	KOLONJE	MUHAMREM	MEZINI		PA VENDIM
118	KOLONJE	BIDO	MEZINI		PA VENDIM
116	KOLONJE	KUTIM	CANE		PA VENDIM
152	KOLONJE	HAXHIDE	PICI	41 HA	
149	KOLONJE	KUTIM	ISAJ	108 HA	
5	KOLONJE	LORENC	LAME	465193	
6	KOLONJE	AQIME	BURIMI	94876	
19	KOLONJE	DYLIBRE	HOXHA	846 HA	
20	KOLONJE	GANI	ISGA	MOS MIRATOJE KERKESEN	
43	KOLONJE	BEKHET	NAZARKO	1240	
47	KOLONJE	VEU	GURA	3480	
48	KOLONJE	KAPLLAN	GRAMO	MOS MIRATOJE KERKESEN	
50	KOLONJE	LEONARD	SHAHU	905 HA	
55	KOLONJE	NEKI	LAME	465193	
82	KOLONJE	KASEM	SHAHU	45719	
94	KOLONJE	ISUF	MEHMETI	MOS MIRATOJE KERKESEN	
100	KOLONJE	POUKSENJI	JANO	NUOHE 1/3 E 969. HA	
88	KOLONJE	VASILUKA	PETRO	31.2 HA	
148	KOLONJE	VLADIMIR	VEZLU	913.5 HA	
153	KOLONJE	ILIA	STEF	35000	
106	KOLONJE	KOLAQ	FOTI	31.2 HA	
112	KOLONJE	ROZETA	PALOU	31.2 HA	
31	KOLONJE	ALI	MESTONI	MOS MIRATOJE KERKESEN	
158	KOLONJE	ELUMA	KACUPI	BSHA	
155	KOLONJE	IBRALE	ZENEU	90HA	
39	KOLONJE	DRAGUSH	LUMI	464 HA	
16	KOLONJE	TOMOR	VEHIBNI	137.49 HA	
77	KOLONJE	FETA	MEMO	154 HA	
45	KOLONJE	SHEFQET	NAZARKO	12.7 HA	
67	KOLONJE	NEVRUZ	MEZINI	45 HA	
89	KOLONJE	JANAQ	LICE	31.2 HA	
96	KOLONJE	NIHAIL	PRIFTI	31.2 HA	
107	KOLONJE	PANDELI	PRIFTI	31.2 HA	
97	KOLONJE	KOCO	JANO	31.2 HA	
93	KOLONJE	KOCO	PRIFTI	31.2 HA	
74	KOLONJE	MEDI	SHAHU	92.5 HA	
14	KOLONJE	PETRIT	QYTEZA	930386	
75	KOLONJE	FUNT	SHAHU	90.5 DY	
83	KOLONJE	KHAMFR	SHAHU	45.3 HA	
64	KOLONJE	EDMOND	KULLA	90.55 HA	
94	KOLONJE	VANGJEL	PRIFTI	31.2 HA	
90	KOLONJE	ROBERT	PRIFTI	31.2 HA	
70	KOLONJE	PERFAQESIA	FSHATIT	MOS SHQYRTIMIN E KERKESES	
52	KOLONJE	HETMIJE			
73	KOLONJE	ADILE		90.5 HA	
99	KOLONJE	THOMA		31.2 HA	
78	KOLONJE	KESMET		90.55 HA	
91	KOLONJE	GJERGJ		31.2 HA	
108	KOLONJE	ILIA		31.2 HA	
79	KOLONJE	FIONIRA		90.55 HA	
109	KOLONJE	THANAS		31.2 HA	
92	KOLONJE	SHMON		31.2 HA	
69	KOLONJE	A FERITA		278.9 HA	
76	KOLONJE	PERFAQESIA E FSHATIT		MOS SHQYRTIMIN E KERKESES	
111	KOLONJE	PETRO	NOTE	31.2 HA	
95	KOLONJE	PETRAQ	PRIFTI	31.2 HA	
110	KOLONJE	DONIKA	AJAZI	13.6 HA	
44	KOLONJE	LIJAN	NAZARKO	104.9 DY	
101	KOLONJE	ABDI	TANE		
104	KOLONJE	JOSEF	TANE	31.2 HA	
150	KOLONJE	DHIMTER	LULA	969 HA	
145	KOLONJE	NIKOLLA	PRIFTI	969.7 HA	
137	KOLONJE	VALTER	KACUPI	969.7 HA	
56	KOLONJE	SAJAMIT	LUMANI	MOS MIRATOJE KERKESEN	
71	KOLONJE	NIJURIE	MALE	MOS MIRATOJE KERKESEN	
129	KOLONJE	ILIO	MELE		34800
132	KOLONJE	VLADIMIR	NAZARKO	28.8 HA	
133	KOLONJE	AGRON	NAZARKO	28 HA	
29	KOLONJE	NEVRUZ	OSMANI	MOS MIRATOJE KERKESEN	
23	KOLONJE	KUTIM	SEMANI	MOS MIRATOJE KERKESEN	
150	KOLONJE	KOCO	TANE	969.7 HA	
103	KOLONJE	SOTIR	MARKU	969.7 HA	
38	KOLONJE	VANGJEL	ZHEKU	969.7 HA	
27	KOLONJE	VESEL	OSMANI	MOS MIRATOJE KERKESEN	
30	KOLONJE	FATMIR	LULO	MOS MIRATOJE KERKESEN	
36	KOLONJE	DASHAMR	VILLAMASI	MOS MIRATOJE KERKESEN	
13	KOLONJE	PASKAL	NANUSHI	MOS MIRATOJE KERKESEN	
34	KOLONJE		PRODANI	MOS MIRATOJE KERKESEN	
11				450 HA	
95	KORCE				PA VENDIM
91	KORCE				PA VENDIM
322	KORCE	DHIMITRAQ	MCICI		PA VENDIM
584	KORCE	AVDYLL	MALO		PA VENDIM
579	KORCE	THEODHORAQ			PA VENDIM
403	KORCE	NAUM			PA VENDIM
88	KORCE	KOSTE			PA VENDIM
819	KORCE	LIU	THANASI		PA VENDIM
1277	KORCE	FAZLU	FAZO		PA VENDIM
968	KORCE	OLLIGA	PAZE		PA VENDIM
1007	KORCE	NEBAI	NEVRUZ		PA VENDIM
800	KORCE	PANDI	MANCE		PA VENDIM
1615	KORCE	ENDER	KULLA		PA VENDIM
16	KORCE	ZARIFE	MBORJA		PA VENDIM
612	KORCE	ISUF	QARRI		PA VENDIM
4	KORCE	FABI	HOXHALLI	147	
1134	KORCE	GJERGJ			PA VENDIM
4	KORCE	BERTI	SULOLLARI	170	
1133	KORCE	STOLI	BRASHIMLLARI		PA VENDIM
334	KORCE	SAFET	ABIPI		PA VENDIM
590	KORCE	PRANVERA	PULAHA		PA VENDIM
496	KORCE	STILJAN	SEVRANI		PA VENDIM
830	KORCE	BEKHET	QYNO		PA VENDIM
8	KORCE	SAIP	BIBA		PA VENDIM
195	KORCE	ILIA	XEXO		PA VENDIM
324	POGRADEC	VASILIL	KOLI		PA VENDIM
179	POGRADEC	LATIF	LICKOLLARI		PA VENDIM

(vijon)

Shpëtohen 450 refugjatë, Italia 'strehon' gratë dhe fëmijët

Fluksi i emigrantëve, Conte: Malta ka shprehur gatishmëri për t'i pranuar, BE të reagojë

Giuseppe Conte, kryemi-
nistri i Italisë njoftoi në
faqen e tij në "Facebook" se
Malta ka shprehur gatish-
mëri për të pranuar secila
nga 50 prej 450 refugjatëve të
shpëtuar në Mesdhe të sh-
tunën, që cilët për orë të tëra
u mbajtën në dy anije usht-
arake. Conte shkruan më tej
se pret që edhe vende të
tjera të BE-së të reagojnë.
Marrëveshjet me Malten
dhe Francën u arritën "pas
një dite me telefonata dhe sh-
këmbime me shkrim" me të
gjithë krerët e 27 vendeve të
BE-së, njoftoi më tej Conte.
Gjatë këtyre kontakteve ai
"u ka sjellë në vëmendje aty-
re logjikën e shpërndarjes

GIUSEPPE CONTE NË "FACEBOOK"

"Malta ka shprehur gatishmëri për të pranuar secila nga 50 prej 450 refugjatëve të shpëtuar në Mesdhe, që cilët të shtunën për orë të tëra u mbajtën në dy anije ushtarake. Presim që edhe vende të tjera të BE-së të reagojnë. Marrëveshjet me Malten dhe Francën u arritën pas një dite me telefonata dhe shkëmbime me shkrim me të gjithë krerët e 27 vendeve të BE-së", njoftoi Conte.

dhe konkluzionet" e samitit të
BE në fund të qershorit. Dy
anije të agjencisë europiane
për mbrojtjen e kufirit, "Fron-
tex", të shtunën shpëtuan në
Mesdhe, duke i sjellë para
brigjeve italiane 450 refugjatë
në gjendje të vështirë, të cilët
lundronin në Mesdhe me bar-
ka prej druri. Ministri i
Brendshëm i Italisë, Matteo

Salvini refuzoi t'i pranojë re-
fugjatët, duke deklaruar se ata
duhen dërguar në Malte ose të
kthehen në Libi. Të premten
e kaluar Roma donte ta bindte
qeverinë e Maltesë që t'i pra-
nonte këta refugjatë. Por Ma-
lta argumentoi se anija ndod-
het më pranë territorit sh-
qetëror italian se sa atij maltez.
Po ashtu, refugjatët prefero-

nin më shumë zbarkimin në
Itali. Ndërsa të shtunën "Fron-
tex"-i i shpëtoi refugjatët nga
barka prej druri duke i shpër-
ndarë ata në anijet e veta usht-
arake. Tetë gra dhe fëmijë u
dërguan për trajtim mjekësor
në ishullin italian Lampedusa.
Ndërkaq, ngjarjet në Mesdhe
konfirmojnë, se arritjet e
samitit të BE-së në fund të qer-



Refugjatët në Mesdhe

shortit duhet të zbatohen shpe-
jt dhe pa ngurrim, shkruan
presidenti Conte në letrën
drejtuar krerëve të vendeve të
BE-së. Në Bruksel, Conte pati
insistuar që vendet e tjera
anëtare të kontribuojnë për
t'u lehtësuar barrën vendeve
në kufijtë e jashtëm të BE-së,
duke pranuar më shumë re-
fugjatë që shpëtohen në det të
hapur. Conte u ka shkruar për
këtë rast edhe presidentit të
Komisionit të BE-së, Jean-
Claude Juncker dhe kryetar-
it të Këshillit Donald Tusk. Ita-

lia ndihet e mbingarkuar me
problemin e refugjatëve.
Qeveria e re në Romë dhe
në radhë të parë ministri i
Brendshëm i së djathtës popu-
liste, Matteo Salvini, insi-
stojnë për më shumë mbësht-
etje nga partnerët në BE.
Për të rritur presionin javët
e fundit disa herë është re-
fuzuar pranimi i anijeve me
refugjatë. Italia është vendi
ku mbërrijnë më së shumti
refugjatët, që përmes Mes-
dheut duan të futen në ven-
det e BE-së.

Donald Trump, presiden-
ti i Shteteve të Bash-
kuara të Amerikës tha
në deklaratën për shtyp të dy
liderëve në Helsinki se takimi
i tij me homologun rus,
Vladimir Putin, është një
"fillim i mirë". Pas dy orësh
bisedimesh me dyer të mbyl-
lura, të dy udhëheqësit sh-
kuan në një drekë pune me
këshilltarët e tyre të lartë.
Duke folur më herët, Putin tha
se ishte koha për të diskutuar
"çështje të vështira shumëko-
mbëshe". Marrëdhëniet
ndërmjet Rusisë dhe Perën-
dimt u rënduan nga aneksimi
i Krimesë nga ana e Moskës në
vitin 2014. Rusia akuzohet
gjithashtu për ndërhyrje në
zgjedhjet e SHBA-ve në vitin
2016, gjë që mohohet fuqi-
mish nga Putin. Duke folur
përpara takimit të parash-
ikuar të së hënës, Trump tha
se shpresonte të një "mar-
rëdhënie e jashtëzakonshme
mes dy vendeve" dhe fajëso-
te administratat e mëparshme
për tensionet Rusi-SHBA. Disa
politikanë amerikanë bënë
thirrje që samiti të pezullohej,
pasi 12 agentë rusë të in-
teligjencës ushtarake u aku-
zuan të premten se kishin ndër-
hyrë në fushatën presiden-
ciale të kandidates Hillary Klin-
ton. Takimi mes dy liderëve
është hapur me një shtrëngim
duarsh që zgjati rreth 3 sekon-
da. Fillimi ka qenë i vështirë,
për të thyer akullin mes dy
presidentëve, që me sa duket
s'dinin nga t'ia fillonin. Por si-
tuatën e ka marrë në dorë
Trump, si mikpritës që i ka
dhënë 'leje' Putinit të ulet dhe
të marrë fjalën. Trump mban-
te kravatë të kuqe, ndërsa Pu-
tin të zezë. "Nuk kemi shkruar
shumë mirë vitet e fundit, por
besoj se do të kemi një raport
të mirë në të ardhmen. Të sh-
kojmë mirë me Rusinë është
një gjë pozitive, jo negative", ka
thënë Trump. Që më pas shtoi:
"Bota po na vëzhgon". Putin-
Trumpit: "Është koha për t'u
përballur me pikat e dhimbsh-
me". Para fillimit të bisedi-
meve konfidenciale, presiden-
ti rus i drejtua kolegët të tij
amerikan: "Kemi kontakte të
vazhdueshme. Kemi folur në
telefon disa herë në kuadër të
ngjarjeve të ndryshme ndërkombë-
tare dhe sigurisht që ka
ardhur koha të flasim në
mënyrë thelbësore në lidhje

Zgjat 3 sekonda shtrëngimi i duarve mes dy liderëve, ja çfarë u diskutua

Samiti Trump-Putin, presidenti i SHBA: Ky është një fillim i mirë

Takimi në Helsinki, kreu rus: Të përballemi me pikat e dhimbshme



Takimi Trump-Putin

DONALD TRUMP

"Nuk kemi shkruar shumë mirë vitet e fundit, por besoj se do të kemi një raport të mirë në të ardhmen. Të shkojmë mirë me Rusinë është një gjë pozitive, jo negative. Bota po na vëzhgon. Në tryezën e bisedimeve ka një numër të madh çështjesh për të cilat duhet të diskutojmë. Është mirë të jesh këtu me ju", ka thënë Trump.

VLADIMIR PUTIN

"Është koha për t'u përballur me pikat e dhimbshme. Kemi kontakte të vazhdueshme. Kemi folur në telefon disa herë në kuadër të ngjarjeve të ndryshme ndërkombëtare. Dhe sigurisht që ka ardhur koha të flasim në mënyrë thelbësore në lidhje me marrëdhëniet tona dypalëshe dhe çështjet e ndryshme në botë".

me marrëdhëniet tona dypalëshe dhe çështjet e ndryshme në botë". Temat në tryezën e bisedimeve ishin tregtia, Kina, raketat dhe bërthamorja. Duke hapur takimin, Trump ka specifikuar që në tryezën e bisedimeve ka "një numër të madh çështjesh për të cilat duhet të disku-

tojmë. Tema shumë intere-
sante, duke filluar nga tregtia,
çështjet ushtarake, raketat dhe
armët bërthamore, si dhe çësht-
jet që lidhen me Kinën,
mikun e përbashkët, presiden-
tin Xi". "Është mirë të jesh këtu
me ju", shtoi presidenti ameri-
kan duke iu drejtuar Putinit.
Është ky samiti i parë dypalësh

i liderëve të të dyja vendeve
qysh në prill të vitit 2010. Për-
para takimit, Trump tha se he-
timet e agjencive amerikane
mbi ndërhyrjen e dyshuar të
Rusisë në zgjedhjet presiden-
ciale në SHBA më 2016-ën i
kanë përkëqësuar rëndë mar-
rëdhëniet e Uashingtonit me
Moskën.



Konkluzioni i komitetit britanik,
gazeta serbe: Rusia, gati për
trazira në Ballkan

Rusia është e gatshme të bëjë gjithçka që mundet për të
destabilizuar Ballkanin. Ky është mesazhi kryesor i
takimit të Komitetit Britanik të Punëve të Jashtme, shkru-
an gazeta serbe "Blick". Sipas gazetës, që sesion u mbajt në
prag të Samitit të sapo përfunduar të Ballkanit Perëndimor
në Londër: Raporti gjithashtu thekson se BE ka lënë pas dore
Ballkanin në 10 vitet e fundit, duke përdorur Rusinë, Kinën
dhe Turqinë për të mbushur këtë boshllëk. Raporti analizon
situatën në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor dhe thek-
son ndikimin rus, edhe pse më i dobët për shkak të pranisë
minimale ekonomike, por më irrezikshëm për shkak se Moskë
është e gatshme për çdo gjë. "Rusia është e gatshme të bëjë
çfarëdo qoftë, ajo mund të destabilizojë Ballkanin Perëndi-
mor dhe rrugën e saj drejt stabilitetit dhe demokracisë. Kjo
është reflektuar në mbështetje të grushtit të shtetit rus në
Mal të Zi 2016", thotë raporti i komitetit britanik. Komiteti
thotë se qëllimet e Rusisë lidhen me forcimin e mar-
rëdhënieve diplomatike me Greqinë, kur Athina dëboi katër
diplomatë rusë për shkak të operimit të tyre të vazhdueshëm
dhe historia fokusohet në pengesën e Rusisë për nënsh-
krimin e marrëveshjes midis Shkupit dhe Athinës për em-
rin e ri të Maqedonisë. "Blic" thekson se në takimin e komi-
tetit u shqyrtuan qëndrimet e shumë ekspertëve mbi Ball-
kanin Perëndimor: Po ashtu, nga gazeta theksohet se Rusia
ka ndërmend që të shkelë Presidentin e Republikës së Ser-
bisë, Milorad Dodik.

KËTO JANË SHENJAT QË PO PINI SHUMË KAFE, TREGONI KUJDES QË TË MOS E DËMTONI ORGANIZMIN!

SUMMER

pages

SUPLEMENT I GAZETËS SHIPTARE

E martë 17 Korrik 2018



KENGETARJA
E NJOHUR

Enca 'çmend' ndjekësit
**"Shumë o nxeht, alamet",
Enca nuk mbahet më**



**Dafina Zeqirit i nxjerrin
momentet intime me të dashurin**

**BULEVARDI
POLITIK**



- Rishfaqet Fatos Nano: Jam simpatik, kam gjysmë orë që bëj selfie...
- Deputeti i Erdogan shkon në parlament me 'Lamborghini'
- Manjani mbledh plaçkat dhe ikën nga Saranda, lë pas një pusullë
- Ministri dorëhiqet pas mesazheve erotike: Jam thellësisht i turpëruar



Rrëfimi/ Jeta me familjen dhe synimet si trajner...ISH-FUTBOLLISTI KROAT

MATKO DJARMATI:

Si e përjetova finalen e "Botërorit 2018"

"Është rezultati më i mirë në historinë e futbollit kroat"

Rrëfimi/ Jeta me familjen dhe synimet si trajner...ISH-FUTBOLLISTI KROAT

Matko Djarmati:

Si e përjetova finalen e "Botërorit 2018"

"Është rezultati më i mirë në historinë e futbollit kroat"

Egla Xhemali

Matko Djarmati që prej 9 vitesh jeton në Shqipëri. Fillimet e veta i pati si futbollist në disa ekipe të Kategorisë Superiore, ndërkaq që vitet e fundit iu fut studimit për të marrë licencën për trajner, shkollë të cilën e ka përfunduar këtë vit. Martesa me Gerta Hetën (Djarmati) prezantuese dhe këngëtare e vendosi përfundimisht Matkon në Shqipëri. Nga martesa e tij erdhën në jetë dy vajza, Luna dhe Matea, e familja është vendi ku ai gjen prehje...

Të kishte shkuar ndërmend që Kroacia do shkonte deri në finale të Botërorit?

Unë do të isha i kënaqur edhe po të ishim në tetëshen më të mirë në botë për ekipin kroat, ekipin e një shteti me 4 milionë banorë. Kisha shpresë sigurisht edhe për finalen, sepse kemi një brez me super lojtarë, që luajnë në klubet më të mira në botë. **Cili është sekretet i Kroacisë, një shtet kaq i vogël dhe kaq i suksesshëm në sport?**

Shumë e vështirë kjo. Nuk ekziston një shpjegim. Besoj kroatët janë shumë të talentuar për sport dhe një shtet kur është në krizë ekonomike, të gjithë fëmijët e shohin sportin si një rrugëzgjidhje, rrugë që do i çojë drejt suksesit. I pari është talenti, e



dyta duhet shumë punë për të qenë i suksesshëm. Kroacia është në nivelet më të larta edhe në handball, në ski, në atletikë. Kemi kampionë të botës në lojërat olimpike. Kroatët me sportin do të dalin ngado.

A janë të gjithë miqtë e tu nga Shqipëria të lumtur për Kroacinë?

Kjo ndoshta është e pabesueshme, po pas ndeshjes me Anglinë, kam marrë mbi 100 mesazhe nga shqiptarët, të njohur edhe të panjohur; në "Facebook" dhe në "WhatsApp",

po ashtu mesazhe të tjera personale. Nuk e mendova që kaq shumë vetë në Shqipëri janë tifozë të Kroacisë.

Si t'u duk finalja e madhe për Kupën e Botës Francë-Kroaci?

Për mua ishte një ndeshje shumë zhgënjyese, për ne kroatët, e ky nuk është vetëm mendimi im, por i të gjithë popullit që e do sportin. Zhgënjyes ishin dy golat e parë, që për mua nuk ishin të rregullt, gabim të arbitrit dhe gjithë sistemit afër tij. Por unë jam i lumtur në fund, pasi edhe po të futeshim në 8 ekipet më të mira në botë,

do isha i lumtur. Tani imagjino sa i lumtur jam kur një ekip si Kroacia mban vendin e dytë në botë në futboll. Pak i zhgënjyer, por prapë jam i lumtur për ekipin kroat, që mori këtë rezultat, më të mirin në historinë e futbollit kroat dhe jam shumë i kënaqur.

Pati reagime nga miqtë virtualë pas ndeshjes?

Jo aq shumë sa në ndeshjen me Anglinë, megjithatë sërish qindra mesazhe thoshin se Kroacia ishte fituese morale e "Botërorit 2018".

Familja juaj jeton në Kroaci, ndërsa me familjen që ju ndërtuat,



rrini në Shqipëri. Si është jeta juaj?

Jam shumë i kënaqur me jetën time të re në Shqipëri, që kur luaja futboll e aq më shumë që tanimë kam dhe familjen time, dy vajzat, Lunën e Matean dhe bashkëshorten, Gerta Hetën (Djarmati). Bëj një jetë familjare dhe ndihem mjaft i qetë. Kur më mungon Kroacia, shkoj atje. Tani sapo jemi kthyer nga pushimet, ishim në Kroaci dhe mallin që kisha e nxorra.


Si ecën jeta juaj profesionale në Shqipëri?

Ka një muaj e gjysmë që kam mbaruar "UEFA-pro", niveli më i lartë i trajnimit për trajner futboll. Tani pas pushimeve kisha disa oferta për të marrë një ekip edhe në Superligë, por mendoj se do shkoj avash-avash, me hapa të vogla, sepse më duhet të nis karrierën si trajner në një projekt të mirë. Por në Shqipëri edhe situata financiare me klubet është shumë e vështirë. Shpresoj që do e gjej edhe unë një ekip ku të jem i kënaqur me punën që do filloj dhe që do jap.




Nora "djeg" rrjetin me foto seksi

Nora Istrefi është një ndër këngëtares me linjat më seksi. Këtë ajo e ka dëshmuar çdo herë në videoklipet dhe fotografitë e saj. Edhe kësaj herë bukuroshja ka "djegur" rrjetin duke postuar fotografi nga pishina, në profilin e saj në "Instagram", në të cilat duket mjaft seksi. Kujtojmë që kënga e fundit e Norës është "As ni gotë", në të cilën ajo po ashtu duket tërheqëse me skenat e vallëzimit si një profesioniste e vërtetë.



Kejvina i habiti të gjithë, ja ç'ka bërë velina

Velina e 'Xing me Ermalin', Kejvina Kthella, është padyshim një prej femrave më të ndjekura dhe ndër më të komentuarat e showbizit shqiptar. Pozat e saj seksi dhe linjat perfekte tërheqin gjithmonë vëmendjen e ndjekësve, saqë shpesh herë e kanë akuzuar se përdor fotoshop. Duket se gjithë këto komente kanë qenë shtysë në publikimin që ka bërë së fundmi velina në rrjetin social "Instagram". Bukuroshja ka postuar një video që ia ka hequr trurin ndjekësve dhe me siguri ia ka mbyllur gojën atyre që e akuzojnë për fotoshop. Kejvina shfaqet me një rrjetë në krahë, të cilën e heq teksa del nga deti, duke ekspozuar të pasmet bombastike dhe këmbët e gjata super në formë. "Hajde flasim pak për fotoshopin", - ka shkruar ajo në videon e publikuar.



"Shumë o nxeht, alamet", Enca nuk mbahet më

Enca ka vendo sur këtë verë ta djegë rrjetin me postimet shumë provokuese duke nisur që nga fotot me bikini blu që postoi pak ditë më parë e ku tregonte të pasmet bombastike. Por, nëse mbetet gojë hapur nga ato foto prisni se nuk keni parë asgjë akoma. Enca e ka nisur javën me një imazh tejet përvëlues. Bukuroshja ka postuar një foto nga palestra ku shihet e veshur me bikini të zeza të tejdokshme në pjesën e poshtme e në një pozicion provokues. "Shumë o nxeht, alamet", është përshkrimi që Enca i ka vënë fotos e nuk kishin si të mungonin qindra komente menjëherë pas postimit.



Dafina Zeqirit i nxjerrin momentet intime me të dashurin

Këngëtarja Dafina Zeqiri prej kohësh është larguar në Amerikë ku dhe po ndjek karrierën e saj atje. Ajo së fundmi publikoi këngën e saj më të fundit 'Fuego', e cila rezultoi shumë e suksesshme dhe u prit mjaft mirë nga fansat. Siç dihet ajo prej vitesh është në një lidhje me një djalë nga Republika Domenikane, i cili quhet Rodrigues. Mirëpo ajo është munduar që gjithmonë lidhjen e saj ta mbaj larg syrit të publikut. Megjithatë, së fundmi në rrjetet sociale po



qarkullon një video ku këngëtarja është filmuar në skena të nxehta me të dashurin e saj. Ata shihen në një klub nate teksa dikush po i filmon duke u puthur. Dafina me shaka ka ngritur këmbën dhe më pas e ka lëpirë të dashurin në fytyrë, veprimet e saj provokuese kanë shkaktuar të qeshura tek ajo dhe tek të pranishmit.



Shumica e njerëzve nuk e fillojnë ditën pa një filxhan kafe, mirëpo lajm i mirë është që kjo ka edhe mjaft përparësi shëndetësore, siç janë jetëgjatësia dhe ulja e rrezikut nga demenca. Mirëpo, teprimi me këtë pije mund të çojë në efekte anësore, të cilat deri tani ndoshta edhe i keni vërejtur, por nuk i keni lidhur me kafën. Natyrisht, nuk duhet të hiqni dorë nga kjo pije, por tregoni kujdes të mos e teproni me sasinë ditore.

JENI TË SHOQETËSUAR

Nga teprimi me kafe bëheni dukshëm nervoz, sepse kafeina stimulon sistemin e mesëm nervor, ndërsa njëkohësisht lidh nivelin e adrenalines, dopaminës dhe glutaminës. Ky kombinim mund të çojë deri te vështirësitë, nervozizmi, rrahjet e shpejta të zemrës, madje edhe deri te shpërthimi i hidhërimit.

ENERGJIA JU BIE GJATË DITËS

Kafja mund t'ju zgjojë shumë shpejt dhe t'ju japë energji, mirëpo kur ajo energji të shpenzohet, do të ndodhë ulje shumë e fuqishme. Disa hulumtime kanë treguar edhe se kafeina mund të shkatërrojë produktivitetin, gjë që mund të çojë deri te sabotimi në punë.

SHPESH JU DUHET TË SHKONI NË TUALET


Kafeina është diuretik, gjë që do thotë që me pirjen e shpeshtë të kafes, do të urinoni shpesh. Edhe pse mund të pini ujë shpesh, nuk do të jeni mjaftueshëm të hidratuar.

ORARI I GJUMIT JU ËSH-TË ÇRREGULLUAR

Ekspertët pajtohen që kafja mund të çrregullojë gjumin dhe të zvogëlojë cilësinë e tij, por edhe gjatësinë. Madje, edhe nëse kafën e konsumoni 6 orë para se të shkoni në gjumë, mund të ndodhë që në mbrëmje të mos flini. Kafja gjithashtu mund t'ju çrregullojë ritmin ditor të organizmit, për çka do të ndiheni të lodhur dhe të plogësht gjatë ditës.

Këto janë shenjat që po pini shumë kafe, tregoni kujdes që të mos e dëmtoni organizmin!

Në çdo gjë duhet të kënaqeni me masë, ndërkah ky rregull vlen edhe për kafën!



Rishfaqet Fatos Nano: Jam simpatik, kam gjysmë orë që bëj selfie...

Ish-kryeministri dhe lideri historik i Partisë Socialiste, Fatos Nano, është rishfaqur, kësaj here në Durrës. Nano ka marrë pjesë në një përkujtimore për luftëtarët e UÇK-së, Ali Ahmeti. Sa ka zbritur nga makina, Nano është pritur nga admiruesit e shumtë, të cilët kanë kërkuar foto me socialistin e vjetër. Në një prononcim për "Ora News", Nano ka thënë se ndihet ende simpatik. I pyetur nëse do rikthehet në politikë, Nano tha se nuk ka për t'u rikthyer në politikën e kulisave. "Ja kam gjysmë orë që bëj selfie. Unë nuk jam larguar nga politika dhe kjo është një pjesë e veprimtarisë sime", tha z.Nano.



Deputeti i Erdogan shkon në parlament me 'Lamborghini'

Kenan Sofuoğlu, ka gjetur një slogan për veten: "Vëllai deputet i të rinjve dhe sportistëve". Dhe shton: "Nusja ime nuk është e kënaqur me këtë vendim. Por ajo, gjithashtu, e di dashurinë time për presidentin dhe më kupton". Njeriu që bente asfaltin të qante tani është deputet, dhe po mundohet të mësohet me kostumin. "Më erdhi një telefonatë nga presidenti, ditën kur do shpalleshin listat e kandidatëve". "Nëse na lejon duam të të shtojmë në listën tonë-më tha, për ju po e pranoj këtë ofertë të thashë. Është një lider shumë i sjellshëm, Nuk më tha se po të shtojmë në listë, por a na lejon apo jo. Po, nuk do e prek rrugën, do e shpërndaj në vende që ka nevojë. Gjatë gjithë kohës që do jem deputet kështu do jetë. Kam dhe makina dhe motore. Nuk kam ndrojtje nga askush. Edhe në vazhdim do të vij përsëri me 'Lamborghini'-n tim. Unë nuk kam bërë asgjë që nuk mund t'ju jap llogari, jam i qetë. Unë jam sportist, më përshtatet një makinë e tillë. Nëse keni mundësi, ju do të merrni më të mirën, do të bëni me të mirën", tha Sofuoğlu.



BULEVARDI POLITIK

Në merrni seriozisht! 😊

Manjani mbledh plaçkat dhe ikën nga Saranda, lë pas këtë pusullë

Pas bërë as tri ditë plazh, ish-ministri Ylli Manjani është detyruar ta braktisë Sarandën. "Thjesht mbledhëm plaçkat dhe ikëm..." shkruan ai në rrjetet sociale duke lënë pas këtë "pusullë": "Kam 7 vite që, çdo verë në Sarandë, bëj të njëjtën betejë me plehrat që nuk i mbledhin! - shkruan ai në FB. - Betejë me bashkinë, por edhe me qytetarët që ku gjejnë shkurre hedhin plehra... Rezultati 0. Sot (dje) është dita e tretë dhe askush nuk vjen t'i pastrojë këto mbetje... Erën spektakolare që vjen aty nuk e përshkruaj dot! Thjesht mbledhëm plaçkat dhe po ikim... Shumë keq! Zhul shekullor..."-përfundon Manjani.



Ministri dorëhiqet pas mesazheve erotike: Jam thellësisht i turpëruar

Një ministër britanik dha dorëheqje pasi u raportua se i kishte dërguar mesazhe seksi dy femrave. "Andrew Griffiths dha dorëheqjen si ministër i biznesit të vogël të premtën në mbledhje për "arsye personale", tha Departamenti për Biznesin, Energjinë dhe Strategjinë Industriale. Griffiths u zbulua se kishte dërguar 2000 mesazhe eksplicite drejt dy femrave në zonën e tij zgjedhore. Ai lëshoi një deklaratë duke kërkuar falje për atë që kishte bërë. 47-vjeçari tha: "Unë jam thellësisht i turpëruar për sjelljen time që i ka shkakuar shqetësime të pallogaritshme gruas e familjes sime, të cilëve u kam borxh gjithçka dhe më vjen turp ndaj kryeminstres dhe qeverisë që jam kaq krenar që i kam shërbyer." Griffiths dorëzoi dorëheqjen në parlament mbrëmjen e së premtes. Ai tha se do të kërkonte ndihmë profesionale për të trajtuar sjelljen e tij të papranueshme duke dërguar tekste seksi.



ARTISTI

SHUHET FADIL HASA

Muharrem Hoxha në lot: Bëmë humor deri çastin e fundit

Me hidhërim të madh njof tojmë ndarjen nga jeta pas një sëmundjeje të rëndë të artistit tonë të shquar, aktorit të pazëvendësueshëm, Fadil Hasa në moshën 78-vjeçare. Homazhet bëhen nesër (sot) në orën 10 - 11 në hollin e Teatrit Teatri 'Aleksander Moisiu' Durrës. Ka qenë ky njoftimi që dha lajmin e humbjes së një prej artistëve më në zë shqiptarë. Fadil Hasa vuante prej kohësh nga një sëmundje e rëndë në mushkëri. Ai do të mungojë çdo ditë të "Ton Ceka" prej kur përshëndeste me batuta aktorë e miq. Ai lindi në Krujë, me 8 prill 1940 dhe kreu gjimnazin "29 Nëntori" në Shkodër, ku u aktivizua në aktrim. Partnerja e tij nëpër role ishte aktorja Aishe Stari për më shumë se 25 vjet. Vetë aktori quante rolet e tij më të mira, ato që kanë mbetur në kujtesën e publikut, me batutat apo personazhet sheqer, sheqer-kryp, kryp, apo personazhi në numrat e humorit "Dajrja dhe parja", etj. Në intervista të dhëna vitet e fundit aktori shprehte shqetësimin për gjendjen e estradave shqiptare. "Gjendja e estradave me atë që unë konstatoj në qytetin tim të Durrësit, por kështu është në të gjithë Shqipërinë është e rrënuar, përdërisa prej tyre shteti është tërhequr, i ka lënë në dorë të bashkive. Ky është gabim i madh për mua, sepse është tjetër interes, bëhen shfaqje nëpër teatro, bëhen në sheshe ku nuk merret vesh asgjë, dhe kur ke një projekt estrade thonë që kanë mbaruar lekët. Kjo më duket se është sëmundje e të gjithë estradave që janë sot", shprehej aktori pak kohë më parë. Duke folur për Estradën e Durrësit, ku kaloi pjesën më të madhe të karrierës ai e quante fat faktin që në këtë estradë ishin dy regjisorët dhe shkrimtarët më të mirë në Shqipëri Gjergj Vlasi dhe Haxhi Rama. I pyetur për pengjet aktori është shprehur se "nuk ka pengje". "Jo, nuk kam pengje. Unë kam qenë një nga kryesorët e trupës së Estradës së Durrësit që jam respektuar dhe nderuar me çmime. Ato që unë kam dëshiruar mi kanë dhënë", është shprehur ai.

KOLEGËT

Disa orë pas ndarjes nga jeta të legjendës së humorit kanë folur ish-kolegët e tij. Muharrem Hoxha mes lotëve tha për mediat duke u shprehur se i ndjeri Hasa ishte një baba i dytë për të dhe do mbetet i paharueshëm gjithmonë. "Jo më larg se dje ishim bashkë në shtëpi duke bërë humor. Ai ishte sëmuri, por është njeri me humor. Fadil m'ka nxjerrë për herë të parë në skenë, ka qenë prind i dytë për mua. Baba im i ka thënë merre Kremën dhe ma mbaj si çunin tat. Kemi mbetur shumë pak sepse jeta bën të veten, dhe dihet që një ditë do na vijë vdekja. Ju falënderoj edhe juve se po të mos ishit ju asgjë nuk do merrej vesh", - tha Hoxha i prekur. Ai shtoi se "sot në 11 e kishim lënë të takoheshim. Do shkoja në shtëpinë e tij. Kam shkruar këto ditë në shtëpinë e tij dhe ishte mirë, kemi qeshur, kemi bërë humor si zakonisht. Sot do shkoja në 11 sërish për vizitë. Por më mori vajza e tij në telefon dhe më dha lajmin e zi, të ndarjes nga jeta. 30 vjet më parë ai humbi gruan dhe iu përkushtua tërësisht vajzave të



Besnik Bisha: U largove qetë, sikur nuk ishte ti që jetove aq vrullshëm

tij dhe nipërve e mbesave. Iu përkushtua shumë familjes pas humbjes së parakohshme të gruas, duke u bërë edhe nënë edhe babë". "Lamtumirë Fadil Hasa! Kam qeshur me ty qysh kur isha fëmijë. Fati nuk na pui në skenë, por mbeta admirues i humorit tënd edhe kur u rrita e u bëra koleg me ty. Duartrokitjet do ta prishin heshtjen tënde në rrugën pa kthim...", shkruante Kastriot Çipi. Në mendjen e publikut do të mbeten të pahar-

rueshme rolet e tij të pjesët "Dajrja", "Sheqeri", "Tekniku i lavatrigës", skeçet e shumta, si dhe rolet në kinematografi ku veçojmë ato në filmat "Mao Ce Dun" (2007), "Kronikë provinciale" (2009) dhe "Zëvendësi i grave" (1987). Në edicionin e 13 të Festivalit Mbarëkombëtar të filmit, Fadil Hasa u shpall "Aktori më i Mirë", për rolin Hekuran Romalin-it të luajtur në filmin "Mao Ce Dun". "Interpretoja personazhin e Hekuranit ka qenë një film i cili u mirëprit

nga publiku. Me këtë film unë kam një kënaqësi të jashtëzakonshme, sepse në pesë festivale ndërkombe-tare të filmit, sot po e them për herë të parë, 5 herë jam nominuar për çmimin si aktori më i mirë, në festivalin e filmit në Moskë, Egjipt, etj.", shprehej ai për këtë rol.

Regjisor i Besnik Bisha Miku tha dje se ai ishte miku i tij dhe miku i të gjithëve. "U largove qetë, paqësisht për në botën e përtejme. Sikur nuk ishte ti që jetove aq vrullshëm. Sikur nuk ishte ti që na dhe aq shumë gëzim. Sikur nuk ishte ti që na bëje të qeshnim si askush. Sikur nuk ishte ti që na jepje kënaqësi kur rrinim bashkë me familjet tona me orë pafund... T'u prehtë shpirti në paqe! Do mbetesh i përvetshëm në kujtimet mia dhe familjes sime. Ngushëlloj familjen që humbën njeriun e dashur prindin, shokun. Oerdë dhe Blerona bëhuni të forta dhe të jeni krenarë për babain tuaj".

Roland Koça tha për mediat se humbja e Hasës është një humbje e madhe si për kulturën shqiptare, ashtu edhe për zemrat e tyre. Sipas Koçës, ne humbëm një monument kulturë. "Për mua sot është humbur një monument kulturë, sepse i tillë ishte si aktor. S'ishte vetëm i Durrësit po ishte i gjithë Shqipërisë. Arti i tij do të kujtohet. Ishte vërtet njeri i mirë. Do thonë ju që në këto raste flitet gjithmonë fjalë të mira, por ne fjalë të mira do themi për dikë që kemi një jetë që e njohim. Humbja e Fadilit është një humbje madhe, pasi nga Durrësi kanë ikur pothuajse të gjithë aktorët e humorit", - shtoi humoristi.

NJË RREFËNJË PËR TË ATIN

Mes shumë komenteve të jena gjatë ditës së hënë, ajo e Ylli Dylgjeri, thotë shumë për natyrën e Hasës. Dylgjeri tregon një ngjarje të 30 viteve më parë, kur Hasa humbi të atin.

Nën titullin "A u mbushën rezervuarët?", Ylli Dylgjeri tregon historinë e mëposhtme. "M'u kujtua sot kjo pyetje e bërë afro 30 vjet më parë nga babai i aktorit Fadil Hasa në çastet e fundit të jetës.

Isim një grup të rinjsh për ngushëllim në familjen e tij kur ai ndërroi jetë. Sipas zakonit, pasi i jepnim dorën Fadilit, uleshin pak çaste e shkëmbenim duhan e muhabet. Pyetja që bëhej rëndom ishte: si vdiq, apo nga se vdiq babai? Dhe i pari i shtipësi tregonte e prapë tregonte...

Ishte kohë vere dhe zakonisht në regjimin e kaluar vuanim për ujë të rrjedhshëm. Kështu nga thatësitrat ishin tharë rezervuarët kudo në hidrocentralet e vendit. Refreni 'Janë tharë rezervuarët' e ka shoqëruar këtë popull në vite. Kështu, sgaronte i ndjeri Fadil sa herë vinte orari për t'i bërë gjilpërën infermierja: Nuk kishte energji për të zjerë gjilpërat...

Oraret shtyeshin e shtyeshin. I sëmuri bëhej nevrik dhe propagandë sërish shtypte sustën: thatësit e tejzgjatit, s'ka ujë, rezervuarët janë boshatisur etj., etj për të qetësuar të sëmurin e shqetësuar.

Na kishte ardhur në majë të hundës kjo fjalë- tregonte Fadil. Ndërkohë, sapo përfundoi së treguari një ngushëllues. hidhet dhe e pyet: "O Fadil - a la gjë me gojë baba përpara se të mbyllte sytë?". Fadili i lodhur nga tregimi që e përsëriste për çdo kureshtar shpërthen: "Po, la! E ngriti dhe një herë kokën para se t'i dilte shpirti dhe pyeti: A u mbushën rezervuarët? - dhe... mbylli sytë".

Fadili, artisti i madh i humorit në vite ka mbyllur edhe ai sot sytë, por ndryshe nga i babai në kohë, ka ndërur jetë me rezervuarët të mbushur. I herë në 30 vjet edhe mbushen! Reshjet e kësaj vere nuk e lanë të ndjerin të interesohet si i ati.

Nën majat e thepisura të Bjeshkëve të Namuna, buzë Lumit Shalë, rikthehet në Theth festivali i parë modern i dedikuar trashëgimisë të Alpeve Shqiptare. Në edicionin e tij të dytë, për dy net dhe tri ditë radhazi, më 20 - 21 - 22 korrik, Za' Fest risjell në Theth muzikën më të mirë shqip, por këtë radhë duke zgjeruar akoma më shumë diapazonin kulturor. Artistët Hasa-Mazzotta, Andorra, Oborri dhe Linda Rukaj do të performojnë live nga Kisha e Thethit. Aktorja Ema Andorra do të interpretojë pjesë nga tregimet, legjendat dhe pe'rallat e moçme, të cilat na rikthejnë shpirtin e paraardhësve. Një repertor i pafundmë, ritmesh, notash dhe vokalesh që mund të përthyejnë çfarëdolloj barriere kulturore. Sfondi i duhur për të shijuar panoramën mahnitëse të Thethit. Ashtu si në

"ZAFEST", KINEMA E MUZIKË NË 1 MIJË METRALARTËSI



edicionin e kaluar, edhe këtë vit Za' Fest shpluhuros nga pesha e harrës pjesë të thesarit gojor të maleve shqiptare, trashëgimi e të parëve tanë. Regjisorja dhe aktoria Ema Andorra do të na rrefejë dhe do të performojë disa nga legjendat më të bukura të zonës. Por, këtë vit përgatituri për një festival gjithëpërfshirës, i cili kombinon muzikën më të mirë live me artet figurative, shijet tradicionale dhe aktivitetet sportive në natyrën e bukur



të Thethit.

Në Za Fest kinemaja shqiptare dhe ajo e huaj do të kenë këndin e tyre, për të dhuruar momente relaksimi me skenografinë më të bukur në botë, majat e Alpeve Shqiptare! Gjatë këtij edicioni, për herë të parë në Za Fest,

do të organizohet një panair kulinarie me ushqimet karakteristike të Thethit, 100% bio dhe të përgatitura me zemër! Yoga, 1000 metra mbi nivelin e detit dhe të rrethuar nga një bukurri përallor. Instruktorët Rachel Berryman dhe Rowie Geraerts do të jenë në Za Fest për të praktikuar bashkë me ne joga, duke na e bërë kontaktin me natyrën e Thethit të pafundmë! Za' Fest është shansi më i mirë për të shijuar natyrën e Thethit dhe bujarinë e banorëve të këtij vendi magjik, me atmosferën që meritonin. Tri ditë e festivalit do të jenë të mbushura me aktivitete si hiking, joga, kinema verore, panair i produkteve lokale dhe shumë surpriza të tjera. Festivali mbahet në Theth, më 20 - 21-22 korrik!

DEBATI

Aleanca e Teatrit: Qeveria po dhuron pronën, ja faktet

Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit ka publikuar dje një analizë me të cilën argumenton se si qeveria po argumenton manipulimin e çështjes së pronës publike.

Duke renditur edhe shkëljet, mes tyre dhe ato të Kushtetutës, Aleanca thotë se llogaritjet vetëm toka mbi të cilën është vendosur thesht godina e teatrove.

QËNDRIMI I ALEANCËS

Problemi kryesorë lidhur me ligjin që lejon rihvillimin e Teatrit Kombëtar dhe zonën përreth, ka të bëjë me përdorimin e tokës publike në këtë projekt. Kohët e fundit, qeveria ka theksuar në publik se pjesa private e projektit "nuk do të prekë pronën e Teatrit". Ky argument i qeverisë, i thënë së fundmi, është përdorur për të kundërshtuar dyshimet se qëllimi i vërtetë i planit është t'i dhurojë tokë publike zhvilluesve privatë të paracaktuar. Megjithatë, ky pretendim i Qeverisë është i rremë pasi shumica e rihvillimit të zonën do të ndodhë në pronën publike. Një dokument i përgatitur nga Aleanca, që i është dërguar dhe ndërkombëtarëve, tregon dhe njëherë se si po manipulon qeveria me këtë problem.

1) Plani i rihvillimit

Për ta ilustruar këtë, në foton më poshtë kemi paraqitur zonën në shqyrtim. Duke përdorur faqen zyrtare të qeverisë shqiptare për parcelat kadastrale, mund të shohim se ky plan rihvillimi ndikon në 11 prona të ndryshme, të cilat në figurën 1 janë vëzhguar me të kuqe:

Duke përdorur të njëjtën faqe interneti, lehtësisht mund të merret informacion në lidhje me sipërfaqen dhe pronësinë e çdo prone. Siç tregohet në Tabelën 1, nga 9026.74 metra katrorë gjithsej, mbi 90 për qind janë në pronësi publike, me vetëm pjesën e mbetur në pronësi të individëve privatë. Përveç pronës me numër kadastrë 1/241, e cila është prona aktuale e Teatrit Kombëtar, publiku zotëron gjithashtu 2600 metra katrorë shtesë në këtë zonë. Pjesa më e madhe e kësaj toke shtesë është në pronësi të Këshillit Bashkiak të Tiranës, i cili, sipas Kushtetutës dhe ligjit për qeverisjen vendore, duhet të miratojë transferimin e një prone tek një palë e tretë me shumicë votash prej tre të pestash.

Tabela 1: Pronat e regjistruara në zonë

Numri i kadastrës	Pronari	Hapësira (m ²)
1/241 Publik	5522.72	
1/66 Publik	1266.58	
1/242 Publik	801.42	
1/197 Privat	336.79	
1/183 Privat	325.4	
1/67 Publik	182.68	
1/239 Publik	169.42	
1/220 Privat	141.95	
1/240 Publik	137.41	
1/62 Privat	90.71	
1/251 Publik	51.66	

"Llogaritjet vetëm toka mbi të cilën është vendosur thesht godina"



Total 9026.74
Total Publik 8131.89
Total Privat 894.85

Ndërsa qeveria publikisht pohon se do të "negociojë me investitorin privat" lidhur me rihvillimin e zonës, në media janë zbuluar makete të cilat tregojnë skemën e përgjithshme të planit. Gjurma e planit të rihvillimit, siç është prezantuar në burime të ndryshme, tregohet në Figurën 2. Sipas tenderit, ndërtesa e gjelbre është Teatri i ri Kombëtar dhe kullat e verdha janë pjesë e zhvillimit privat të zonës.

2) Përdorimi i tokës publike

Siç shfaqet poshtë, është pothuajse e pamundur të ndërto-

het ajo që është planifikuar pa shkelur pronën publike. Sipërfaqja e tokës që aktualisht është pronë private është shumë e vogël dhe kufizohet vetëm në një shirit të ngushtë, siç shihet në Figurën 3.

Pyetja nëse zhvillimi privat do të ndodhë apo jo në pronën me numër 1/241, që sot është toka e Teatrit, është plotësisht e pavlerë. Pjesa tjetër e pronës publike do të rihvillohet për interesa private si në mënyrë për të justifikuar rihvillimin e Teatrit. Për më tepër, është pikërisht kjo pika që Qeveria ka shkelur Kushtetutën duke marrë një pronë të Këshillit Bashkiak pa zhvilluar votim në Këshillin Bashkiak për ta miratuar këtë proces me 3/5 e votave!

Tabela 3: Pronat e regjistruara në zonë

Numri i kadastrës	Pronari	Area (m ²)
1/241	Publik	5522.72
1/66	Publik	1266.58
1/242	Publik	801.42
1/197	Privat	336.79
1/183	Privat	325.4
1/67	Publik	182.68
1/239	Publik	169.42
1/220	Privat	141.95
1/240	Publik	137.41
1/62	Privat	90.71
1/251	Publik	51.66
Total		9026.74
Total Publik		8131.89
Total Privat		894.85

Ndërsa qeveria publikisht pohon se do të "negociojë me investitorin privat" lidhur me rihvillimin e zonës, në media janë zbuluar makete të cilat tregojnë skemën e përgjithshme të planit. Gjurma e planit të rihvillimit, siç është prezantuar në burime të ndryshme, tregohet në Figurën 2, me gjelbër, ndërtesa e gjelbre është Teatri i ri Kombëtar dhe kullat e verdha janë pjesë e zhvillimit privat të zonës.



Figure 2: Zona e rihvillimit të Teatrit Kombëtar

Figure 2: Zona e rihvillimit të Teatrit Kombëtar

Figure 2: Zona e rihvillimit të Teatrit Kombëtar

Figure 2: Zona e rihvillimit të Teatrit Kombëtar

Figure 2: Zona e rihvillimit të Teatrit Kombëtar

Figure 2: Zona e rihvillimit të Teatrit Kombëtar

Figure 2: Zona e rihvillimit të Teatrit Kombëtar

Figure 2: Zona e rihvillimit të Teatrit Kombëtar

Figure 2: Zona e rihvillimit të Teatrit Kombëtar

Figure 2: Zona e rihvillimit të Teatrit Kombëtar

Figure 2: Zona e rihvillimit të Teatrit Kombëtar

Figure 2: Zona e rihvillimit të Teatrit Kombëtar

Figure 2: Zona e rihvillimit të Teatrit Kombëtar

Figure 2: Zona e rihvillimit të Teatrit Kombëtar

Figure 2: Zona e rihvillimit të Teatrit Kombëtar

Figure 2: Zona e rihvillimit të Teatrit Kombëtar

Figure 2: Zona e rihvillimit të Teatrit Kombëtar

fikojë rihvillimin e pjesëve të saj. Ekziston një tjetër shqetësim, nëse duam t'i besojmë planeve të bëra publike. Ndërtesa e propozuar e Teatrit Kombëtar do të ketë formë të ngjashme me një papion, siç shihet në Figurën 2. Sallat e teatrit do të vendosen mbi katin përderes. Ky i fundit do të shërbejë zyrtarisht si një "hapësirë publike" e hapur, por në të vërtetë do të jetë rruga drejt kullave private prapa kompleksit teatror. Në fakt, vetë Teatri Kombëtar nuk do të ketë truall të tijin.

3) Nevoja për një ligj të veçantë

Nëse autoritetet publike thekshet do të jepen leje për të zhvilluar pronën private në këtë zonë, që ilustron në Figurën 3, ata nuk kishin përse të kërkonin një "ligj të veçantë". Megjithatë ky është dukshëm një projekt i dëmshëm nga pikëpamja urbane dhe historikokulturore, të gjitha instrumentet ligjore për dhënien e një leje ndërtimi tashmë ekzistojnë në legjislacionin shqiptar, ndaj nuk ka përse të shpiken ligje të reja. Arsyeja përse është propozuar një "ligj i veçantë" është unifikimi i të gjitha pronave publike në një plan të vetëm rihvillimi dhe pastaj transferimi tek ndërtuesit privat. Një plan i tillë, siç është përshkruar më lart, është një shkelje e Kushtetutës pasi Këshilli Bashkiak nuk ka dhënë lejen për ta transferuar pronën tek një palë e tretë, siç është shprehur nga deklaratat e mëparshme të Aleancës.

4) Shënime përmbyllëse

Ajo që vlen të ritheksohet është se dallimi me pronën publike të Teatrit apo jo është tërësisht i pavend dhe i shpikur nga qeveria për të justifikuar planin e saj. Mbi 90 për qind e zonës në fjalë është pronë publike dhe do të të rihvillohet nga private, teorikisht për të justifikuar kostot e një teatri të ri. Ka shumë të ngjarë që gjithashtu një pjesë e terrenit aktual të Teatrit do të jetë pjesë e rihvillimit privat. Kjo është arsyeja pse ky "ligj i veçantë" është propozuar nga qeveria, edhe pse ai shkel Kushtetutën.

"Il fatto quotidiano": Në Tiranë do shembet teatri italian, akuzat hedhin hije mbi negociatat me BE

Çështja e Teatrit Kombëtar i ka kaluar tanimë kufijtë e Shqipërisë. Gazeta italiane "Il fatto quotidiano" ka publikuar një artikull me titull "Në Tiranë do shembet teatri italian, akuzat për spekulime hedhin hije mbi negociatat me BE". Artikulli vëren se parlamenti e ka miratuar ligjin që i hap rrugë shembjes së teatrit dhe në vend të tij ka një projekt arkitektësh të njohur danezë, por që është kundërshtuar fort nga artistët,

opozita dhe qytetarët. Shënohet se janë hedhur "akuzat të rënda për përfitime nga politika e Partneriteteve Publike-Private (të cekur nga FMN dhe hedhin hije mbi negociatat me BE) për të krijuar fitime të dyshimta.

"Zemra italiane e Tiranës ka të ngjarë të vazhdojë të fshihet nga buldozerë dhe ligje të veçanta. Duhet hapësirë për ndërtesa të reja, pikërisht atje, në ato pak mbetje të qendrës historike të kryeqytetit shqiptar", shkruhet në gazetën italiane.



"Zemra italiane e Tiranës ka të ngjarë të vazhdojë të fshihet nga buldozerë dhe ligje të veçanta. Duhet hapësirë për ndërtesa të reja, pikërisht atje..."

Opinioni

i Ditës

Kush do ta bëjë vetingun e vetingut?

Nga Agron Tufa

(vijon nga faqja 1)

... në këto kritere implikimin (shkallën) e këtij populli, përgjithësisht të errët, si bashkëpunëtorë të diktaturës komuniste.

Këta prokurorë/gjyqtarë/hetues - folje ndihmëse të shtypjes diktatoriale, i kanë duart të zhyera deri në bërnyla me gjakun e qytetarëve të pafajshëm. Ata kanë dënua politikisht, kanë hetuar, survejuar dhe kanë çuar në pushkatim jetë njerëzish anembanë atdheut.

Si ka mundësi që për Platformën e Vetëingut kjo nuk përbëka asnjë arsye për t'u ndaluar? Si ka mundësi që mashtrimet, fshehjet, vjedhjet e korruptimet e ndryshme qenkan më gjëmëmëdha se tragjeditë familjare që kanë shkakuar këta vegla të diktaturës në shoqërinë shqiptare? Pra, të jesh vrasës, qenka ku e ku më lehtë se të jesh hajdut (!).

Thjesht mungesa e një penalteti të tillë të vetëingut allashqiptarëve më neverit dhe po të kisha vullnet, do preferoja t'i pështyja në fytyrë për këtë fyerje kombëtare njerëzore gjithëpopullore. Këtij vetëingut i vjen era PAZARË, spastrim Pazarësh të Vjetra për hir të Pazarëve të Reja.

Më troc: Ideatorët, Platforma dhe Komisioni i Vetëingut ka qenë që në zanafillë e këtij prej brumi enverist, kokë për kokë (bëjeni vetë provën nominalisht), përndryshe nuk mund të ndodhte kurrsesi kjo, që hajduti të ishte më i



dënueshëm si shkallë krimi nga sa është një vrasës, gjakpirës.

Kjo më çon ndërmend poezinë e nobelistit Josif Brodskij (Letra mikut romak), kur thotë: Larg më mirë nga çdo Cezar e çdo tufan.

Pa nguti e frikë që të bën sahanlëpirës.

Gjithë regjentët thua se hajdutët janë?

Po më mirë besa hajdutë, se gjakpirës.

Prandaj vetëingut pa kushtin e penaltetit të gjyqtarëve që i shërbyen shtypjes dhe krimeve të komunizmit është hipokrit, i rrezikshëm, i pamjaftueshëm, rrjedhi-

misht për t'u neveritur e për t'u pështyrë në surrat.

Nga ana tjetër (sepse çdo medalje ka dy anë), kush na garanton se kush ua bëri vetëingut anëtarëve të Komisionit të Vetëingut? Po atyre që i zgjodhën apo i propozuan? Kush ishte i pari? Kush e kap hallkën e parë të zinxhirit "të shkaqeve dhe pasojave"? Si mund të pritë transparencë nga një lëmsh i zi katrani?

Ndokush mund të mendojë se më leverdiska mungesa e vetëingut. Jo! Lexoni mirë çfarë thashë! Mos u bëni tutkunë! Mendjet e shëndetshme e inteligjente duhet t'i zërë krupa nga ky vetëingut pa pikë morali!

Opinioni

Sportiv

Janë francezë dhe pikë



Nga Ervin Baku

Franca, kampionia e re e botës, i paskërka futbol listës e saj afrikanë. Nuk qenka kombëtare e vërtetë. Hajde mentalitet, hajde! Franca nuk i ka gjet gati futbollistët afrikanë. Ata janë afrikanë të lindur, të rritur, të formuar, të edukuar, të bërë futbollistë në Francë. Patë ndonjërin me flamurin e vendit të origjinës??? Jo. Të gjithë me flamurin e Francës. Pse??? Po sepse flamuri i Francës është flamuri i tyre. Pse??? Sepse Franca është vendi i tyre. Franca është prova absolute e shanseve të barabarta. Edhe në sport. Afrikanët sh-

këlqejnë jo vetëm sepse kanë fizik, por edhe sepse e shohin sportin si një mundësi shumë të mirë integrimi. Flas gjithmonë për ata që duan të integrohen. Sporti në përgjithësi, futboli në veçanti, bashkojnë njerëzit.

Unë e di që për këtë temë ka pro dhe kundër. Por unë nuk kam ndërmend të debatoj. Mendimin tim e keni më lart. Ky është mendimi im. Në fund të fundit, mendoj se njeriun nuk e bën vendi nga ka origjinën, por formimi dhe edukata që ka marrë. Dhe mbi të gjitha, aftësia e tij për t'iu përshtatur realitetit. Dhe në rastin konkret, një realiteti të shkëlqyer.

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT MË VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE
LAJMET E FUNDIT NE
APARATIN TUAJ



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

Opinioni

i Ditës

Takimi Trump-Putin si Jalta e dytë për shqiptarët

Nga Ralf Gjoni

(vijon nga faqja 1)

... dhe ekzekutuar me mjesh-tërinë e gangsteriale të një kauboj-si me armë në brez. Është një ske-nar teatral që i ngjan më tepër fil-mave western se sa politikës së jasht-me. Me politikën e re botërore, jo vetëm Shqipëria, por shqiptarët si komb dalin të humbur e të dobësuar, njëllor siç dolën prej Konferencës së Jaltës në 1945.

Presidenti Trump është një pres-ident anti-konvencional, kontro-versial në kulm, i zjarrtë, instiktiv e imponues, i cili me deklaratat e tij spontane e të papritura po tej-kalon imagjinatën e shumicës së analistëve të marrëdhënieve ndërkombëtare e po lë me gojë hapur politikanët kryesorë të vendeve të aleancës perëndimore.

Brenda një jave në dheun evrop-ian, Trump provokoi tërmet në samitin e NATO-s duke kërcënuar me tërheqjen e SHBA prej Aleancës më të fortë ushtarake në botë, u shpreh se mes NATO-s Britanisë dhe Rusisë, takimi me Putin mund të ishte më i lehti, ofendoi Kryemi-nistren britanike Tereza May në shtëpinë e saj duke sugjeruar se plani i saj për Brexit nuk do të funk-siononte dhe se Sekretari i Jashtëm i sapo-dorëhequr Boris Johnson mund të ishte një Krye-mnistër shumë i mirë për britani-kët, si dhe theu të paktën dy pro-tokolle mbretërore ndaj Mbretëreshës Elizabeth II. E më pas, një ditë përpara takimit me Presidentin rus Putin, e quan Bash-kimin Evropian një armik publik të Shteteve të Bashkuara.

Për të mos u futur në detaje të tjera të bëmave globale të presiden-tit amerikan, është e qartë se Trump ndjehet më rehat me Kim Jong-un dhe Putin se sa me politi-kanët përfaqësues të Kanadasë, Gjermanisë, Francës, Britanisë dhe teknokratët e Brukselit, të cilët, në këtë katundin tonë sh-qiptar i duam kaq fort.

Trump e luan politikën sikur të ishte një arenë boksi biznesi, ku nuk ka partnerë, por vetëm konkurrentë, ku të drejtat e njeriut apo vlerat demokratike perën-dimore janë vetëm fabula librash, e për rrjedhojë si bishë e fortë bi-znesi, presidenti i ri amerikan nuk beson tek aleancat, por tek lufta e ashpër për terren e fitim të një-an-shëm. Për hir të vërtetës, Trump i ka qëndruar besnik sloganit të tij të singertë të fushatës elektorale "America First", ku interesat e pas-tra komerciale amerikane pre-valojnë mbi çdo të drejtë ndërkom-bëtare apo komb të tjetër.

Në këtë kontekst, rendi botëror i pasluftës, një krijim thellësisht amerikan, ndërtuar mbi aleancën e kombeve perëndimore dhe mbi përhapjen e vlerave demokratike në botë si standard qeverisës – ka rënë!



Dhe kjo për amerikanët apo për vetë rrethin komercial e politik të familjes Trump nuk është aspak negative. Trump me të drejtë po i shërben maksimalisht dhe pam-ëshirshmërisht interesave prag-matike e strategjike të Shteteve të Bashkuara, duke e pozicionu-ar vendin e tij jo më si një fuqi demokratike me barrën për të nxirur demokracinë e mirëqenien në botë, por si më të fortin e lagjes, si një gangster me të cilin as nuk duhet të të shkojë ndër mend të përballesh.

Ndaj dhe popullariteti i tij në SHBA ka arritur maja historike, sepse votuesit amerikanë, pavar-ësisht rolit të padiskutueshëm global të vendit të tyre gjatë këty-re 70 viteve, nuk e njohin botën dhe as të mirat që ajo i sjell ekon-omisë amerikane.

Në këtë kontekst, Trump beson se shkundja e themeleve të OKB, e Bashkimit Evropian dhe e NATO-s e pozicionojnë Washing-tonin në avantazh me vendet e tjera, ndërkohë që rrisin popullar-itetin e tij brenda territorit ameri-kan. Dhe këtu ka të drejtë, sepse vepron me logjikën e një afaristi të egër që mendon vetëm për fiti-min dhe aspak për produktin që tregton.

Në këto terma u zhvillua edhe samiti mes Presidentëve Trump dhe Putin, si dy të fortë të lagjeve respektive, të cilët i dhanë dorën njëri-tjetrit për të mbrojtur inter-esat e tyre komerciale. Ky takim që më tepër i shërbeu Rusisë se sa SHBA, ka tërbuar shumë kon-gresmenë e senatorë në Washing-ton, të cilët e kanë cilësuar samitin si të turpshëm e tradhti kombëtare.

Në fakt, përmbajtja e takimit

dhe 'dashuria' e re Trump-Putin sugjeron se ky takim i ngjan më tepër një Jaltë të dytë, pas të cilit fshihet rendi i ri botëror që do vu-losë fatet e shumë kombeve për një periudhë të konsiderueshme ko-hore.

Konferenca për shtyp Trump-Putin rikonfirmoi vullnetin e të dy vendeve për të negociuar prag-matikisht e mbi baza komerciale, si dy konkurrentë të denjë globalë e si dy fuqi të padiskutueshme bërthamore në botë.

Në mes të këtyre negociatave komerciale e bërthamore, dhe një-lloj si Jalta e parë (e cila si për ironi të historisë ndodhet në Krime), Sh-qipëria e shqiptarët si komb do marxhinalizohen e do injorohen gjithnjë e më tej, nëse ata vetë nuk bëjnë diçka për veten e tyre.

Është më se e qartë se SHBA ka vite që e ka humbur interesin ndaj Ballkanit duke ia deleguar nd-jekjen e aferave politike e diploma-tike të vendeve si Shqipëria apo Kosova, nivelin ambasadorial. Përfaqësja amerikane ndaj Sh-qipërisë filloi të ndryshojë pas Pres-identencës së Bush Junior ku Sh-qipëria në shtatë e Departamentit të Shtetit ndryshoi statusin nga një aleat strategjik i amerikanëve në rajon, në një vend kandidat për BE. Prioriteti i ri i politikës së jashtme amerikane gjatë presidencës Obama ishte mbështetja e integrit-it evropian të Shqipërisë, që de-fak-to do të thoshte shkëputje gradu-ale të SHBA nga rajoni.

E pra, takimi Trump-Putin, i cili vjen pas një antagonizmi të ashpër të Washingtonit ndaj Bashkimit Evropian, është lajm i keq për Sh-qipërinë, për Kosovën e për të gjithë shqiptarët, të cilët duan të integro-hen në një entitet problematik për

Washingtonin, siç është BE.

Dhe sikur të mos mjaftonte kjo, shkëmbimet politike e komerciale mes Trumpit dhe Putinit, ku të dy do japin diçka që të marrin diçka tjetër, mund të rezultojnë në një largim definitiv të SHBA nga ra-joni i Ballkanit, i cili as që nuk hyn në interesat ekonomike apo strategjike të të dy vendeve, pavar-ësisht fabulave ballkanike që ne i tregojmë njëri-tjetrit.

Ndaj dhe në këtë kontekst të ri, shqiptarët, si një popull de-mografikisht në rënie e provincial në çdo kuptim të termit, duhet të mendojnë për interesat e tyre prag-matike ekonomike për të rriden-uar aleancat e së ardhmes.

Tashmë që BE na e tha qartazi se nuk na e kanë ngenë, e pas skandaleve të njëpasnjëshme të teknokratëve pjanecë e qejflinj evropianë, politika e jashtme sh-qiptare duhet të fillojë të ndërtojë aleanca specifike me natyrë bilat-erale, për t'iu përgjigjur nevojave imediate investuese në vend, sepse potencialet nuk mungojnë. Serbia ka vite që po e aplikon këtë strategji, dhe me shumë sukses.

Ndaj dhe sfida kryesore e poli-tikës së jashtme shqiptare sot mbetet largimi prej përrallave me integrim e aleanca strategjike, dhe orientimi i interesave tona kombëtare thellësisht drejt in-teresave investuese që gjener-ohet punësim e mirëqenie për ata pak milionë që do mbesin kënde-j nga anët tona. Thënë shkurt me fjalët e Bill Clintonit, "It's the Economy Stupid".

Ndryshe kombi shqiptar do vetëmbytet mes eposit ballkan-ik ose do përfundojë duke i ndër-ruar pelenat ndonjë plaku gjer-man...

HOROSKOPI

DASHI

Kushtojni vëmendje shëndetit këtë peri-udhë. Bëni kujdes për ato çfarë do të consu-moni. Mund të keni humbje nëse investoni pa marrë keshillën e duhur. Anëtarë të famil-jes mund të mos përbushin pritshmëritë tuaja. Mos prisni që ata të veprojnë sipas dëshirës suaj.

DEMI

Bëni kujdes të veçantë për ndjenjat e të tjerëve kur jepni një gjykim. Çdo vendim i gabuar, jo vetëm që do të ndikojë tek të tjerët por do t'ju dëmtojë edhe ju psikologjikisht. Do të kaloni një ditë interesante me miqtë, plot me aktivitetë. Megjithatë mos dëni vullnetarë për të paguar pasi do të përfundoni në shtëpi me xhepa bosh.

BINJAKET

Emocionalisht nuk do të ndihenit të sigurt dhe nuk do të dini se çfarë kërkoni. Bëni shumë kujdes me financa. Shëndeti i femrave në familjen tuaj nuk do të jetë i mirë. Marrëdhënia në çift do të jetë shumë e mirë, por nuk do të zgjasë shumë. Nëse jeni të martuar do të kaloni një ditë plot stres.

GAFORJA

Presioni nga shefat në punë dhe mosmar-rëveshjet në shtëpi do t'ju shkaktojnë stres. Kjo do të ndikojë negativisht në përqendrimin tuaj në punë. Mos ia impononi mendimin tuaj të tjerëve dhe dëgjoni çfarë thonë të tjerët nëse doni të shmangni konfliktet. Ka gjasa të përjetoni një tjetër lloj romance.

LUANI

Është koha e duhur që të kontrolloni peshën tuaj trupore, të nisni ushtrimet fizike dhe kujde-seni maksimalisht për shëndetin. Ana financia-re nuk do të jetë ashtu siç dëshironi, pasi do t'ju dalin disa të papritura. Marrëdhëniet personale do t'i keni nën kontroll. Nëse keni në plan të udhëtoni bëni shumë kujdes për valixhen.

VIRGJERESHA

Rualet qetësinë me çdo kusht, sepse mund t'ju kushtojë dëme të pari-parueshme. Nëse kontrolloni veten, do të jeni në harmoni. Sot përpikuni të mos shpenzoni. Duhet të respektoni të tjerët dhe të keni besim tek ata. Sa i përket dashurisë, është dita juaj me fat.

PESHORJA

Gjatë ditës së sotme do të përballeni stres, për shkak të presionit në punë. Ana financia-re do të përmirësohet dhe kjo do t'ju bëjë të bëni blerje të rëndësishme. Nëse jeni prind, do të jeni shumë të angazhuar pas pune. Kujdes kur të flisni me partnerin tuaj, kontrol-loni fjalët se mund të lëndoni njëri-tjetrin.

AKREPI

Do të ndihenit të lodhur fizikisht e mendërisht për shkak të hidhërimit. Sjellja juaj prej kokë-for-titë do të ofendojë familjarët dhe miqtë tuaj të ngushtë. Sot do të kuptoni se partneri juaj është ai që ju do të dashurojë gjatë gjithë jetës. Kujdesi për look-un tuaj do t'ju sjellë kënaqësi.

SHIGJETARI

Puna e barrësive që keni ndërmarrë sot do t'ju sjellë pagë mendore. Gjendja financiare do t'ju përmirësohet në pjesën e dytë të ditës. Megjith-atë, bëni kujdes me shpenzimet, sepse duhet të mendoni edhe për të ardhmen. Partneri/partnerja juaj do të jetë shumë romantike sot.

BRICJAPI

Ju do të keni kohë të mjaftueshme për veten tuaj sot. Dini për një shtëpi të gjatë, do t'i shërbeje shëndetit tuaj. Vështrësitë finan-ciare duket se do të kapërcejnë falë ndih-mës së prindërve tuaj. Dialogu i duhur dhe bashkëpunimi do të përmirësojnë mar-rëdhënien me bashkëshortin.

UJORI

Ju mund të keni nevojë t'i drejtoheni spitalit për problemet shëndetësore. Nuk është një ditë e mirë për të bërë investime. Dikush me të cilin jetoni do të jetë shumë i acaruar me veprimet tuaja të fundit. Dashuria e njëan-shme do të prishtë lumturinë tuaj.

PESHQIT

Bëni ushtrime fizike për të qenë sa më shumë në formë, pasi kjo do të ndikojë edhe në shëndetin tuaj mendor. Mos shpenzoni më shumë seç keni mundësi. Do të keni një ditë të lodhshme me fëmijët tuaj. Kontrolloni natyrën tuaj impulsive, sepse mund të sh-kaktojë miqësinë.



Parisi dhe e gjithë Franca priti heronjtë e saj. Avioni me në bord kampionët e rinj të botës u ul në aeroportin "Charles De Gaulle" në orën 17:00, ndërsa të parët që zbritën nga aeroplani ishin kapiteni Hugo Loris dhe trajneri Didier Deschamps, me trofeun e Kupës së Botës në duar. Një oqean njerëzish kishin dalë në bulevardin më të rëndësishëm të kryeqendrës franceze, "Champs Elysee", për të

Makron i takon në pallatin "Elysee"

Parisi pret me madhësi heronjtë e Moskës

nderuar heronjtë e tij dhe për t'u dhënë 23 lojtarëve dhe stafit teknik një përqafim të ngrohtë. Pavarësisht vapës së madhe, bulevardi ishte i tejmbushur nga qytetarët e Parisit, por jo vetëm, pasi ishin të

shumtë ata që donin të përshëndetnin beniaminët e tyre. Autobusi me 23 heronjtë e Moskës hyri në bulevard i shoqëruar nga forca të rrepta sigurie. Deschamps dhe djemtë e tij u përshëndetën me tifozët e

panumërt dhe u nderuan nga parada e forcave ajrore që krijuan flamurin trikolor në qiellin e Parisit për të shkuar më pas në pallatin Elize, aty ku i prit presidenti Emmanuel Macron.

Ish-sulmuesi i Real Madridit është i lumtur për zgjedhjen e bërë dhe është gati për sfidën e re

Ronaldo prezantohet te Juventus: Zgjedhje e lehtë, vij te një klub i madh Portugezi: Në moshën time, lojtarët ikin në Kinë




Nëse do të duhej ta sintetizonim debutimin e Kristianos në Itali, fjala e duhur do të ishte padyshim "Sfida". E përsëritur shpesh herë nga goja e sulmuesit. "Me

Realin ishte një histori e shkëlqyer, falënderoj tifozët, por nuk besoj se po qajnë për mua. Tani kam një sfidë të re dhe mesazhi për të tjerët është: Nuk kam se çfarë t'i tregoj

asgjë askujt. Dua të lë shenjën time dhe te Juventus. Seria A është shumë taktike dhe e vështirë, por më pëlqen të gjendem në situata të reja. Do të jetë e vështirë, por në karrierën time nuk kam pasur kurrë asgjë të lehtë. Besoj te Juventus pasi ishte oferta e vetme që më erdhi".

Pastaj tema Champions League, ëndrra më e madhe në Torinon bardhezi. "Liga e Kampioneve? E di që të gjithë skuadrat duan të fitojnë Ligën e Kampioneve, nuk është e thjeshtë, por ekziston mundësia që klubi të arrijë këtë objektivi. Do të luftojmë për çdo trofe, është e vërtetë që turnetë mund të jenë të vështirë. Por duhet të jemi të qetë. Liga e Kampioneve është e vështirë të fitohet, unë shpresoj të ndihmoj. Juventus i ka shkuar shumë afër në vitet e fundit, pastaj finalët janë gjithmonë surprizë. Unë shpresoj të sjell fat".

Kroaci



Këngë e flakadanë për Luka Modrić me shokë

Por jo vetëm Franca. Avioni me në bord përfaqësuesen e Kroacisë, u ul në orën 16:00 në aeroportin "Franjo Tuzhman", ndërsa "të zjarrtëve" iu rezervua po e njëjta pritje madhështore nga populli ballkanas. Vendi i dytë ishte një arritje e madhe për Zlatko Dalić dhe 22 lojtarët e tij, ndërsa Zagrebi i pritë ata si fitues të vërtetë. Qindra mijëra kroatë në sheshin qendror dhe në rrugët që të çonin drejt tij, ndërsa turma niste nga aeroporti dhe vijoi për gjatë gjithë kilometrave deri që qendër të qytetit. Manxukiç me shokë nuk ngurronin të firmosnin autografe, ndërsa me mbërritjen e tyre në qendër të Zagrebit në sheshin "Josip Jelačić", festa arriti kulmin, me popullin kroat, që u dha ngrohtësi dhe emocione të pabesueshme idhujve të tyre, që siguruan medaljen e argjendtë në Kupën e Botës "Rusi 2018".

Jeton Selimi

Kristiano Ronaldo prezantohet te Juventus. Ndonëse zyrtarizimi ishte bërë ditë më parë. Fakti që ai u shfaq në sallën e konferencave të klubit bardhezi, i bëri të gjithë të besojnë se një nga lojtarët më të mirë të historisë ka zbarkuar në Serinë A. Në fjalën e tij, Ronaldo përmendi shpesh fjalën "sfidë" si dhe premtoi trofe. Pra, paska qenë e gjitha e vërtetë! Në orën 18:32 të së hënës 16 korrik 2018, Kristiano Ronaldo hyri në sallën "Xhani dhe Umberto Anjeli", salla më e bukur e Allianz Stadium. Me të, e gjithë familja dhe Kristiano argëtohet me gazetarët. "Zgjedhja ishte e lehtë, pasi ky është klubi më i mirë në Itali dhe një nga më të mirët në botë. Këtë vendim e kisha marrë prej kohësh. Besoj se është një hap i rëndësishëm për karrierën time. Ka një trajner të madh dhe presidenti është mësuar të fitojë si edhe unë. Jam ende shumë i ri dhe kam shumë për të dhënë. Kam shumë sfida përpara. Siç e dini lojtarët në moshën time shkojnë në Kinë apo në Katar, ndërsa unë erdha te Juvja dhe e falënderoj që mendoi për mua".

E konfirmojnë në Brazil

Zidan nuk e donte Neymar te Reali për shkak të Marcelos



atë nuk e tërhiqte ideja pasi mendonte se Marcelo dhe Neymar nuk mund të luajnë

bashkë, përveç rasteve kur kanë përballë skuadra të vogla. Sipas Zidan, ata mbulonin të njëjtën zonë të fushës, ndaj nuk e shihte me sy të mirë blerjen e Neymar, ishte shpjegimi që kishte marrë gazetari brazilian. Të shohim tani nëse Lopetegui e mendon në të njëjtën mënyrë afirmimin e mundshëm të brazilianit, për të cilin madhëritë, në fakt, insinuojnë se nuk po bëjnë asnjë ofertë, ashtu siç kanë thënë më parë për Zidan, Ronaldo, Bejl...

Klubi i Serisë B do mbrojtësin kuqezi

Breshia, ofertë konkrete Mërgim Mavrajt


E ardhmja e Mërgim Mavrajt vendoset këtë javë. Klubi i Hamburgut ka vendosur që të largojë mbrojtësin me çdo kusht si pjesë e shkurtërme për pjesëmarrjen në Bundesligën 2 dhe është dakord edhe t'i paguajë një kompensim të vogël. Gjithçka ka të bëjë tashmë me destinacionin që do të ndjekë lojtari, nëse do të shkojë në Spanjë apo në Itali. Sido që të jetë, pritë që të vazhdojë karrierën në kategorinë e dytë. Oferta e parë që i ka mbërritur futbollistit 32-vjeçar që nuk bën më pjesë në planet e Hamburgut, është ajo e Deportivo La Korunjes, një klub me

shumë traditë që kërkon të kthehet sa më parë në elitën e futbollit spanjoll. Por kjo nuk është oferta e vetme. Mavrajt i kanë ofruar mundësinë që të tregojë aftësitë e tij edhe në atë që cilësohet si "shkolla e mbrojtësve", futbollin italian. Oferta që i ka mbërritur mbrojtësit shqiptar është nga klubi i Breshias në Serinë B, por për momentin nuk është ndër destinacionet e preferuara të tij për shkak të pagesës që nuk arrin standardet e larta me të cilat është mësuar në vitet e

fundit. Në këtë pikë, është gati të ndihmojë Hamburgu. Klubi gjerman i ka bërë të ditur Mavrajt se mund të largohet si lojtar i lirë ndonëse ka kontratë edhe për një vit, si dhe do t'i paguajë diferencën mes rrogës që do të marrë në klubin e ri si dhe asaj që do të përfitonte këtë vit te Hamburgu. Një zgjidhje që do të linte të kënaqura të gjithë palët dhe sipas informacioneve nga Gjermania, do të mbyllë brenda kësaj jave karrierën e Mavrajt në këtë vend.

Zinedin Zidan e kishte zgjidhja të qartë që kur filluan të dilnin zërat për transferimin e Neymar në radhët e Real Madrid. Braziliani nuk bënte për madhëritë dhe për të nuk kishte asnjë dyshim, aq sa u kishte shpjeguar edhe miqve të tij arsyen pse kishte insistuar disa herë që klubi të mos bënte ofertë për të. Sipas mediave braziliane, një mik i Zidan ka shpjeguar arsyetimin pse ai nuk dëshironte që Neymar të luante dhe kjo kishte të bënte vetëm me çështje teknike dhe taktike. "Ishte në darkë me një mik të Zidan dhe e pyeta se pse kishte zëra se francezi nuk dëshironte Neymar", shpjegoi gazetari i njohur brazilian Andre Rizek. "Ky mik i tij më tregoi se

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. Eshhtë babëzia.
8. Burton regjisor.
11. Skllavja e Abrahamit.
12. Një ditë në mbledhje.
14. Tyson i boksit.
15. Rrethojnë ringun.
17. Beson pa kufij.
19. Zola që shkroi Nana.
20. Eshhtë ankimum.
23. Pak elementarë.
24. Janë me para në bankë.
26. Matet pa kufij.
27. Janë ngrahina për repert fabrikash.
28. Një zog i verdhë.
29. Inicialet e Moravia-s.
31. Qytet gjerman.
34. Një zonjë që ha gurë.
35. Pak analogji.
36. I ka plasur të aturpit.
37. Janë legjendat.

38. Nuk ka akoma një bebe.
39. Fillojnë mirë.
40. Janë brinjë në skuadër.
42. Shkruhet i shtati.
44. Nget edhe ajo e mirë
47. Mbahet në gisht.
48. Janë numrat 1, 3, 3...

VERTIKAL

1. Kanë shpate të tilla.
2. Janë edhe ato polare.
3. Janë mizorët.
4. Janë male në Rusi të tilla
5. Eshhtë nusja me vello.
6. Një rreth pa ekstreme.
7. Mbyllin kuvendin.
8. Në kryr të titujve
9. Diku në qendër.
10. Markë cigaresh.
13. Janë rrëfimet e të pandehurit.
14. Janë penjtë për gjergjef.

16. Mbarojnë fare.
18. Janë stitët e... provimëve.
20. Mund të jenë fotografikë të tillë.
21. Vitet pa kufij.
22. Një fjalë për tutje.
24. Brown i Kodi i Da Vinci-t.
25. Eshhtë e akuzuara... injorante
26. Baldwin aktor
27. Një pjesë e kandidatëve.
28. Krenar pa çift.
30. Grazia Cucinotta.
32. Paul këngëtar.
33. Janë pëstjellat.
35. Inicialet e Moravia-s.
37. Pak makinacione.
38. Samuel bomber kamerunas.
40. Markë makine koreane.
41. Ente Kombëtare Durrës.
42. Fillojnë kurat.
43. Inicialet e Zemeckis regjisor.
45. Ekstreme në litat.
46. Fillojnë lejen.

Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


1. Satelit i Uranit.
6. Eshhtë edhe ai i Pallës.
11. Tiran pa kufij
12. Një krye të armatës.
13. Një Ibrahim violinist.
14. Qendër ditore.
15. Mund të jenë fotografikë.
17. Inicialet e Einstein.
18. Një mbishkrim në kryq.
20. Janë si vite.
21. Thurman aktore.
22. Të parat në irritim.
23. I preu Seneka.
25. Fillojnë ilustrimet
26. Isaac Asimov.
27. Një Vladimir kompozitor.
28. Janë në modë.
30. Janë zyrat... qeveritare
32. Me të nxjerrin trarë.
35. Një shkop, thupër.

VERTIKAL


37. Eshhtë Shqipëria e madhe.
39. U thyen në Salamina.
40. Një raport shumë i ngushtë.
41. Nota e diapzonit.
42. Fund heroi.
43. Një top në rrjetë.
45. Gjysma alarmi.
46. Herët pa zë.
47. Sampras i tenisit.
48. Me të bëjnë triko.
49. Një guajitje fluturimthi në tenis.
50. Janë kokrrat e lisit.

VERTIKAL


1. I famshëm ai i Sizifit.
2. Mund të jetë e hollë dhe therëse.
3. Fillojnë rastësisht.
4. Një pjesë e napolitanëve.
5. Janë situatat e rrezikshme para portave.
6. Mund të jenë kundërajrore.
7. Lindin në kokë.
8. Gjysmë shtegu.
9. Hidhen të parat.
10. Eshhtë njeriu i përsosur.
13. Një fjalë për tutje.
15. Fundi i një samurai.
16. Mbyllim me epilog.
17. Bel i maupassant.
19. Inicialet e Redford.
23. I manifeston nxënësi i papërgatitur.
24. Në hyrje të tokës.
26. Pak impresioniste.
27. Janë metrat në sipërfaqe
29. Hapet një për ajër.
30. Gjysmë krenar.
31. Një hidrokarbur.
33. Vrau Hektorin.
34. Një film i rixhiruar.
36. Kupat pa kufij.
38. Inicialet e Nolte aktor.
41. Ullmann aktore.
43. Një brilantinë moderne
44. Hotel pa kufij.
46. Ekstremë në hall.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

			3		6	8		7	9
7			4	5	3		2		
	8	9							
	2			4				7	
				1		5			4
			8	7			6		
			6	5					
6							4	9	
		3		7					

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

4	1	2	5	6	8	3	7	9
5	3	6	7	9	1	8	2	4
7	8	9	2	3	4	1	6	5
8	2	4	9	1	5	7	3	6
6	5	3	8	7	2	4	9	1
9	7	1	3	4	6	5	8	2
1	6	7	4	8	9	2	5	3
2	4	8	6	5	3	9	1	7
3	9	5	1	2	7	6	4	8

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

1	K	3	U	7	L	2	T		14	4		9		7	4	19
8		10	5			1	4	12	2	6	7	5			10	
10	4	7			4	1	2	8	10	6	4	7	5			
18				1	7	5	8	9	4	2	10	4				
6	5	1			6	2	10	5	2	5					12	
	7	1			17	5		1	5	10	17	4				
2	5	10	17	4	2			4	10		6	15	5			
8		2	8	12		15		6	10	17	5					
18	10	5	16	19		6		4	8		10	1				
6		7	5		6	11	5		9	19	6	7				
4	11	4	7	6	2	6	1	5		7	17	6				
12	5	2	5		12	1	6	15	4	2					8	

M	A	S	H	U	R	K	A		I	R	A	K
E	S	T	E	R		A		D	H	U	N	A
	I	T	E	A	T	E	R		M	I	N	
E	R	A				P	O	L	A	R		T
K	E	L				P	O	L	E	M	I	K
L						P	O	L	I	G	A	M
E	T	A				P	I	K	A	T		R
K	O	M	O			D	E	N	T	O	K	E
T	R	I				S	E	T	M		N	U
I	T					T	U	T	U		I	T
K	A	D	E	T			K	O	S	H		L
E	T	I	K			S	E	K	S	E	R	E

Argëtim filozofik

- Një mik gjatë gjithë jetës është mjaft, dy janë shumë, tre pothuajse është e pamundur.
- Kur interesohesh, nuk harron... kur kujdesesh, nuk i kthen shpinën mbrapa, kur do...nuk kërkon kohë... kur dashuron nuk lëndon!!!
- I vetmi person që mund të kontrollosh në një marrëdhënie, është vetëvetja.
- Gjëja më e mirë që ka për të bërë dikush që nuk është i sigurtë në vetveten e tij, është të heshtë.

Thënie të mençura

- Për të kërkuar arsyen se pse një dashuri mbaroi, është sikur të kërkoesh arsyen se pse ajo filloi !!!
- Nëna është si qiri, që djeg veten për të ndriçuar jetën tonë !!!
- Për gjërat që nuk mund të flasësh, duhet të heshtësh.

- Heshtja është flori, kur nuk mund të mendosh një përgjigje të mirë.
- Problemi më i madh i komunikimit, është se, nuk dëgjim për të kuptuar, por për t'u përgjigjur.

PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

P	E	T	R	I	K	A	A	S	P	A	K
T	R	U	P	T	A	L	E	N	T	I	A
R	A	C	T	I	K	A	B	E	T	E	R
B	A	K	U	N	I	N	A	N	E	M	I
T	A	M	A	R	O	C	I	I	I	H	
P	I	E	E	N	A	O	D	R	E		
K	A	T	I	O	N	D	E	A	L	M	A
K	E	S	A	P	E	T	E	R	E	A	F
E	L	S	A	V	A	L	R	O	N	E	
R	I	T	M	A	L	L	A	R	M	E	T
M	A	B	U	S	E		H	A	N	E	T
O	R	E	K	S		B		D	E	M	O
R	A	S	T	I	K	A	B	E	T	E	R
I	B	A	K	P	E	R	I	T	O	N	I
A	I	K	I	M	B	O	I	N	I	R	K
T	A	S	A	P	A	G	A	N	I	N	I
T	A	V	E	R	A	D	O	I	N	I	M
Y	M	A	R	S	I	A	N	E	T	J	A
H	A	R	A	K	I	R	I	E	R	I	T
A	S	I	I	R	A	D	A	M	E	S	
S	H	A	M	A	T	A		L	O	T	U

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)



www.gsh.al
GAZETA SHQIPTARE

Gazeta e gjithë shqiptarëve!



Kontakt: +355 68 40 63 842

Facebook: Gazeta Shqiptare

Instagram: gazetashqiptare.al

Twitter: Gazeta Shqiptare

E-mail: gazetashqiptare.al@gmail.com

Youtube: Gazeta Shqiptare

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!



www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al